

MAL BERISHA:

Me shkrimtarin, poetin, përkthyesin dhe gazetarin,
Ndrek Gjini, isha njohur nëpërmjet shkrimeve të tij.

Kjo njohje u konkretizua nga afër, kur unë pata
nderin të përfaqësoja Shqipërinë, si Ambasador në
Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe,
Irlandës së Veriut dhe Irlandës. Ndreka ishte
vendosur në këtë të fundit, prej disa vitesh dhe jetonte
e punonte në një nga qytetet e saj, Galway.

U vura në kontakt me të dhe ndërtuam një miqësi,
e cila ishte krejt në shërbim të promovimit të
Shqipërisë dhe Kosovës në Irlandë.

Të lexosh këtë libër,
do të thotë të mësosh për shumë njerëz,
ngjarje e ndodhira
aq interesante dhe të rëndësishme,
por thuajse tërësisht të harruara.

Çmimi: 500 lekë, 5 euro

NDREK GJINI

(Sh) KRIME NË HISTORI

- Publicistikë -

Ndrek Gjini

(Sh)KRIME NË HISTORI

- Publicistikë -

Tiranë, 2020

NDREK GJINI
(Sh)KRIME NË HISTORI
- Publicistikë -

Redaktor:
AGRON SEJAMINI

Copyright © Ndrek Gjini 2020

NGJARJE E NDODHIRA INTERESANTE DHE TË RËNDËSISHME, POR THUAJSE TËRËSISHT TË HARRUARA

nga **MAL BERISHA**
Ish-ambasador, historian, shkrimtar dhe përkthyes

Me autorin e këtij libri, shkrimtarin, poetin, përkthyesin dhe gazetarin, Ndreka Gjini, isha njohur vetëm nëpërmjet shkrimeve të tij, nëpër gazetatat shqiptare.

Kjo njohje u konkretizua nga afër, kur unë pata nderin të përfaqësoja Shqipërinë, si Ambasador në Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe, Irlandës së Veriut dhe Irlandës. Ndreka ishte vendosur në këtë të fundit, prej disa vitesh dhe jetonte e punonte në një nga qytetet e saj, më perëndimore, në Galway.

U vura në kontakt me të dhe kjo bëri që të ndërtonim një miqësi, e cila ishte krejt në shërbim të promovimit të

Shqipërisë dhe Kosovës në Irlandë. Si një shkrimtar dhe aktivisti Bashkisë së Galway-t, ai mundësoi hapje ekspozitash për 100 vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë në qytetin ku jetonte.

Më tej bashkëpunimi ynë, u shtri edhe në aktivitete të përbashkëta, për shkak se puna e Ambasadës tonë në Londër shtrihej edhe në Irlandë.

Me datën 10 tetor të vitit 2013, unë paraqita letrat kredenciale, tek Presidenti i Republikës së Irlandës, Sh.T. z. Michael D. Higgins. Takimi me atë burrë shteti dhe intelektual të shquar të Irlandës, ishte shumë mbresëlënëse në çdo aspekt. Duke e pas njohur mirë që përpara statujën e Presidentit irlandez, mendova që ta "surprizoja" me një gjest shumë të thjeshtë, pa asnjë shpenzim, por shumë kuptimplotë. Për këtë, ndonëse pa e pyetur, më erdhi në ndihmë autori i këtij libri, Ndreka, kësaj radhe si përkthyes.

Ai kishte njohje me Presidentin Irlandez, për shkak se ky i fundit, ishte një ndër themeluesit e shoqatës "Miq të Irlandezë të Shqipërisë", ku bënë pjesë shumë intelektualë të qytetit Galway.

Ndreka kishte përkthyer në gjuhën shqipe një seri vjershash të Michael D. Higgins dhe i kishte botuar në Gazetën Nacional në Tiranë. Unë i mora ato vjersha, i printova dhe i lidha bukur në një liberth dhe gjatë audiencës private me Presidentin, ia dhurova atij.

Presidentit i shndritën sytë. Ai as që e priste një gjë të tillë. Pasi i hodhi një sy ai më tha:

“Jam shumë i nderuar dhe i lumtur. Kam shumë libra të mijtë të përkthyer në gjuhë tjera, të cilat gjenden në bibliotekën time, por nuk kam asnjë të tillë të përkthyer në shqip. Ky do ta zbukurojë koleksionin tim, madje do ta vendos në krye të tyre.”

I thashë me shaka se i takon, pasi emri i vendit tim fillon me germën “A”. Ai qeshi dhe më tha: ***“Jo, jo thjesht për këtë arsye! Unë e njoh autorin, por nuk e dija se më paska përkthyer në gjuhën e nënës së tij.”***

E përmenda këtë fakt, për të vënë në pah një nga cilësitë e autorit të këtij libri dhe ndikimin që ka patur veprimtaria e tij e shumëanëshme letrare jo vetëm në jetën e tij, por edhe në promovimin e Shqipërisë në një vend si Irlanda.

Libri “(Sh)Krime në Histori” është një kolazh rrëfimesh shumë interesante, të cilat Ndrek Gjini, i ka mbledhur me shumë përkujdesje. Në fakt ai i ka mbledhë si bleta piklat e mjaltit e të polenit nëpër cepa të ndryshëm të botës. Kështu ai ka vënë në një seri aq interesante ngjarjet që kanë të bëjnë përherë në një mënyrë ose në një tjetër me Shqipërinë dhe shqiptarët.

Personazhet e këtij libri janë emra shumë të njohur të lidhur me historinë e Shqipërisë, në një mënyrë ose një tjetër.

Vetë titulli është shumë intrigues, pasi ai luan me germen "Sh" në thojza, duke vënë dy fjalë: Shkrimin dhe krimin. Në të vërtetë ai duke shkruar këtë libër ka zbuluar edhe shumë veprime të cilat shkojnë deri në definicionin e krimit.

Ndreka shkon në këtë libër deri në zonat më të largëta malore të Shqipërisë, në Valbonën, ku ecën mbi kalë njëri nga njerëzit më të shquar, pra të udhëtarit britanik që ka shkruar librin "Land of Eagles", Robin Hanbury - Tenison. Në libër gjejmë një sygjërim shumë interesant për mbrojtjen dhe ekspozimin për efekte turizmi dhe njohje elementët e ruajtur paganë në Shqipëri, ashtu siç ka bërë Irlanda në vitet tridhjetë të shekullit të kaluar.

Autori na sjell fakte të rralla, siç është kumbaria e Preng Bib Dodës me Napoleonin e Tretë, si edhe dhuratën që komunistët shqiptarë i bënë Hrushovit, duke i dhënë kostumin e mrekullueshëm shqiptar të veshur nga Preng Bib Doda.

Në libër lëvizin personazhe me fat tragjik, shqiptar të talentuar dhe vlera të vërteta për kombin si Rexh Meta, i adaptuari i gazetares më të madhe të kohës së vet, Roze Wilder Lane.

Më tej, gjen përshkrimin për fatin tragjik të atyre që formuan Lidhjen e Dytë të Prizrenit. Autori ndalohet tek akti fisnik i shqiptarëve në mbrojtjen e hebregjeve, gjatë Luftës së Dytë

Botërore të personifikuar në figurën e Kolë Bibë Mirakës, i cili ndihmoi në përcjelljen e hebrenjve drejt zonave të lira e të sigurta të Italisë së Jugut.

Rrëfimi i Meave de Burgh, që i bën mbesës së saj të famshme irlandeze, Miss Botës 2013, Rosanna Davison, rreth fatit të keq të patriotëve shqiptar që u martirizuan prej tradhëtisë së madhe të Kim Philbit është tronditës. Ai është një rrëfim i alternuar midis çarmit të një bukuroshje dhe tragjedisë së qindra shqiptarëve që ranë në duar të sigurimit të shtetit, për faj të asaj tradhëtie.

Në shkrimin për Dom Nikoll Kaçorin, autori ndalet tek kontributi - jo aq i vënë në pah - i njërit nga patriotët më të mëdhenj të kombit shqiptar të shekullit të njëzetë.

Po ashtu, ai nuk harron të shënojë atë, Nënë Tereza, e cila e kishte filluar misionin e saj pikërisht në Irlandë, me punën e saj për paqën në zonën më të rrezikshme të Irlandës së Veriut, pikërisht aty ku vdekja sillej çdo ditë - në Ballymurphy.

Në libër "hasen" dy figura të ndritura, simboli i rezistencës anti komuniste në Shqipëri - Pjetër Arbnori si dhe autori i librit "Tradhëtia e Madhe", Lordi anglez Nicholas Bethel në një rrëfim rrëqethës rreth tradhëtisë së Kim Philbit.

Një kohëzgjatë gati e pabesueshme, e sjell librin e Lordit, të nënshkruar prej tij për Mbretëreshën Gerladinë, në bibliotekën e autorit të këtij libri, cili e ka blerë këtë libër

online në Amazon. Në një botë kaq të madhe, ndërlidhen gjërat në një mënyrë aq spontane, sa të bëjnë që me të vërtetë të habitesh.

Autori nuk ka lënë pa përmendur edhe fakte interesante nga jeta e Ismail Qemalit, themeluesit të shtetit modern shqiptar.

Të lexosh këtë libër do të thotë të mësosh për shumë njerëz, ngjarje e ndodhira aq interesante dhe të rëndësishme, por thuajse tërësisht të harruara.

Libri i shton bibliotekës së Ndrek Gjinit edhe një titull të ri dhe interesant.



Paganizmi dhe... turizmi

*... investimi në mbledhjen,
ruajtjen dhe konservimin e vlerave,
traditave dhe praktikave pagane do t'i
sjellë Shqipërisë më shumë turistë
se sa deti apo bregdeti
Adriatik dhe Jon të marrë së bashku.
E vetmja gjë që mund të bëjmë ne,
është një aksion i madh kombëtar për
mbledhjen dhe konservimin dokeve,
zakoneve, traditave, këngëve dhe
praktikave pagane të jetesës. Kjo është
urgjente, pasi brezi i 70-80-vjeçarëve
shqiptarë, janë muzeu i gjallë.*

● —————

*Arsyet pse ai paganizmi ka
mbijetuar në Shqipëri janë të shumta.
Në rrënjët e këtyre arsyeve gjenden
histori turpi e krenarie, izolimi e
vetizolimi, histori betejash të humbura
e të fituara, harresë, kameleonizëm,
inate, vetmi, hatërmbetje e gjëra të këtij
lloj. E rëndësishme është që paganizmi
në Shqipëri është ende gjallë, ndërkohë
që trajtat e tij të fundit në Europë
kanë dhënë shpirt para 30 - 40 vjetësh
në Skoci, Irlandë apo Norvegji.*

————— ●

Paganizmi shqiptar nuk është primitivizëm e as barbarizëm siç mundohen ta etiketojnë disa. Ai është vlerë etnokulturore që duhet mbrojtur, konservuar e më pas promovuar për turistët e huaj dhe për brezat e rinj të Shqipërisë. Ruajtja dhe konservimi i tij është një detyrë e ngutshme si për komunitetin ashtu dhe për pushtetin ekzekutiv e atë legjislativ në Shqipëri.

Pa dashur të shfaq poza historiani apo etnologu, mund të them se paganizmi është ende gjallë në Shqipëri dhe se duhet ruajtur e konservuar si vlerë

etnokulturore prej së cilës mund të kemi veç përfitime në industrinë e turizmit.

Shqipëria është një nga vendet e vetme në Europë, ku për fat të mirë paganizmi ende jeton. Pushtimet e gjata që nga ato Romake e deri tek ato të dekadave të fundit, si dhe zhvillimet e vrullshme të këtij kontinenti kanë fshirë çdo gjurmë paganizmi. Arsytet pse ai ka mbijetuar në Shqipëri janë të shumta. Në rrënjët e këtyre arsyeve gjenden histori turpi e krenarie, izolimi e vetizolimi, histori betejash të humbura e të fituara, harresë, kameleonizëm, inate, vetmi, hatërmбетje e gjëra të këtij lloji. E rëndësishme është që paganizmi në Shqipëri është ende gjallë, ndërkohë që trajtat e tij të fundit në Europë kanë dhënë shpirt para 30-40 vjetësh në Skoci, Irlandë apo Norvegji.

Hapja e Shqipërisë si dhe zhvillimet e vrullshme të këtij vendi në këto afro tre dekadat e fundit kanë bërë që paganizmi shqiptar të plakët, dobësohet e lihet në harrese. Këto, janë kostot e hapjes dhe zhvillimit. Këto, janë ligje universale e për rrjedhojë ne nuk mund të bëjmë përjashtim.

E vetmja gjë që mund të bëjmë ne, është një aksion i madh kombëtar për mbledhjen dhe

konservimin dokeve, zakoneve, traditave, këngëve dhe praktikave pagane të jetesës. Kjo është urgjente, pasi brezi i 70-80-vjeçarëve shqiptarë, janë muzeu i gjallë. Para pak vitesh, kur po shkruaja disertacionin mbi traditat zakonore të dasmave irlandeze në shekullin e 18-të dhe 19-të, m'u desh të hulumtoja nëpër disa arkiva e biblioteka të Irlandës. Mësova se ajo ka arkivin më të madh në Evropë të folklorit me mjaft elemente pagane. Arkivi ende i gjallë shqiptar i paganizmit, është shumë më i madh dhe më i pasur se ai irlandez. Në vitet 1937-1938 qeveria irlandeze, bazuar në një vendim që mori Parlamenti, akordoi një fond dhe ndërmori një aksion dyvjeçar për mbledhjen dhe grumbullimin e pasurisë folklorike dhe etno-kulturore.


U angazhuan të gjitha shkollat fillore, të mesme. Çdo nxënësi iu dha një fletore, me një pyetësor të gjerë e të detajuar për çdo aspekt të jetës, traditave, zakoneve, këngëve, mënyrës se si procedohej në kultivimin, korrjen apo ruajtjen e të korrave, zakonet e lindjes, dasmave dhe vdekjes, data, histori lokale, emra, fise, gjenealogji. Për dy vjet në Republikën e Irlandës nën mbikëqyrjen e

mësuesve i plotësuan këta pyetësorë, vunë mjaft foto, dorëzuan dhe objekte të vjetra, e kështu me radhë. Një Komision Shtetëror bëri më pas seleksionimin, skedimin dhe arkivimin e tyre në një ndërtesë të ndërtuar enkas për këtë qëllim. Dhe sot, pas kaq dekadave, Irlanda ia arriti edhe t'i dixhitalizojnë këta arkiva, duke e bërë këtë vend ndër më tërheqëset në botë për turizmin me drejtim trashëgiminë kulturore.

Ne tani jemi vendi i vetëm në Europë, ku paganizmi është ende i gjallë. Ky është një shans fatlum dhe duhet shfrytëzuar shpejt, pasi koha nuk pret.

Pas pak vjetësh një pjesë e mirë e këtij paganizmi do të ketë vdekur. Është koha të bëjmë atë që irlandezët bënë më 1937-1938. Dhe ta bëjmë tani. Jam i sigurt se një investim i tillë në mbledhjen, ruajtjen dhe konservimin e vlerave, traditave dhe praktikave pagane do t'i sjellë Shqipërisë së viteve 2018-2028 më shumë turistë se sa deti apo bregdeti Adriatik dhe Jon të marrë së bashku.

15.07.2018



Tenison,
libri i tij "Land of Eagles",
dhe... një ministër shqiptar!

*...këshilla ime është ta lexojë
Këshilltari për Kulturën i Kryeministrit
të Shqipërisë dhe t'i sugjerojë
Kryeministrit që t'i shkruajë Robin
Hanbury-Tenison një letër falënderimi
për botimin dhe kërkojë ndjesë për
sjelljen e padenjë të
"Ministrit të Kulturës, të vitit 2007".*

● —————

*Në çdo faqe të këtij libri ndihet
dashamirësia dhe mikpritja e popullsisë
rurale, e cila hapi për Tenisonin dhe
ekipin e tij, dyert e shtëpive, u ofruan
atyre bukë të ngrohtë, djathë të bardhë
të kriposur, dhallë dhe raki.
Kështu që sjellja fodulle e ministrit,
tretet dhe harrohet tek lexon
më se 200 faqet e tjera...*

————— ●

Në librin "Land of Eagles", të botuar para pak vitesh në Angli, me autor Robin Hanbury-Tenison, përveç fjalëve të mira që fliten për Shqipërinë dhe mikpritjen shqiptare, shpaloset dhe shëmtia, fodullëku, dhe mosmikpritja e ministrit shqiptar të Kulturës të vitit 2007, dhe djalit të tij. Ministri i Kulturës, në këtë libër, nuk përmendet me emër, ndaj dhe unë po e lë pa emër. Autori i këtij libri, Robin Hanbury-Tenison, është një personalitet i vlerësuar nga revista

'Time' si eksploratori më i madh në botë i 20 viteve të fundit.

Në fillimvjeshtën e vitit 2007 ai vizitoi Shqipërinë. Së bashku me gruan e tij, hipur mbi kuaj, nëpër shtigje malesh, dhe jo rrugëve me asfalt, ata e përshkruan hapësirën shqiptare nga Veriu në Jug.

(Ky libër nuk besoj të jetë përkthyer ende në shqip. Ndofta dhe po. Por qëllimi i këtij shkrimi nuk është thirrje për përkthim, dhe as komenti rreth tij, i cili, mendoj se është shkruar mirë, dhe përgjithësisht flet shumë mirë për Shqipërinë dhe shqiptarët, përveç katër-pesë faqeve ku flitet për një gjest të pakulturë të ministrit të Kulturës).

Çfarë ka ndodhur realisht atë natë në bujtinën mes maleve?

Nga faqja 32 deri në faqen 37 të këtij libri, autori përshkruan rrugëtimin e ekipit të tij, se si hipur mbi kuaj ata kaluan nga Thethi në

Valbonë. Ai përshkruan bukuritë magjepëse të natyrës, aventurat e asaj rruge, shiun që i lag, lodhjen, urinë, rreziqet që paraqisnin ato shtigje të ngushta etj. Ai tregon sesi pak pa rënë nata, në afërsi të Valbonës, ata kishin humbur rrugën. Më tej përshkruan skenën kur aty kalon një makinë policie e më pas disa fuoristrada. Ata ndalojnë, përshëndeten, madje dhe prezantohen midis tyre. Një nga pasagjerët që zbret nga fuoristrada prezantohet para tyre si ministri i Kulturës i qeverisë shqiptare. Bisedojnë për pak minuta. Dikush u tregon me dorë shtegun që të shpie te bujtina e vetme në atë zonë... dhe më pas ministri me eskortën e tij hipin në makinat e tyre dhe largohen.

Tenison me gruan e tij dhe shoqëruesin bëjnë edhe nga dy orë rrugë hipur mbi kuaj, deri në bujtinë, shkruhet në librin 'Land of Eagles'. Kur mbërrijnë, janë të lagur, të uritur, të lodhur e të stërmunduar nga rruga e gjatë. Pikërisht tek ajo bujtinë kishte shkuar për të darkuar edhe ministri i Kulturës me djalin e tij, së bashku me disa të tjerë.

Pronari i bujtinës ua hap derën dhe i mirëpret. Por e gjithë vëmendja është e përqendruar te

ministri. Askush nuk do t'ia dijë se Tenison, gruaja e tij, dhe shoqëruesi janë të lagur, të uritur e të lodhur. Në dhomën e pritjes së kësaj bujtine as ministri dhe as i biri, nuk denjojnë të ngrihen e t'u lëshojnë pak vend...

Robin tregon se atyre u shërbehet për të ngrënë nga ato pak ushqime tanimë të ftohta që kanë mbetur prej tavolinës ku kishte ngrënë ministri me grupin e tij. Ai tregon si ministri luan pultin e televizorit duke ndryshuar kanalet me shpejtësi, pa ia ditur fare për mysafirët e huaj që ndodhen aty. Tregon si ai dhe i biri janë mosmikpritës deri në paturpësi dhe fodullë të pa fre.

Autori i këtij libri përshkruan gjithçka në detaje, sesi ministri fillon t'i japë mend rreth nevojës së reklamimit të bregdetit shqiptar dhe jo zonave malore...

Tenison konkurren në Festivalin
e Kanës me filmin e tij për Shqipërinë

Eksploruesi britanik Robin Hanbury - Tenison
në faqet e këtij libri i ka përshkruar me thjeshtësi,

singeritet dhe vërtetësi të admirueshme përshtypjet e kësaj aventure shqiptare. "Vendi i Shqiponjave, me kuaj përmes vendit të harruar të Europës" është një libër i cili është promovuar para disa kohësh në Royal Geographic Society në Londër, një nga qendrat më prestigjioze të eksplorimeve, që financon eksplorime në vende të ndryshme të botës.

Në faqet e këtij libri shpaloset bukur Shqipëria me kulturën, historinë e pasur, doket e zakonet shqiptare.

"Shqiptarët janë një popull mikpritës. Shqipëria është një vend që për vite me radhë është veshur me misteriozitet përballë publikut të huaj. Unë dua t'u tregoj njerëzve realisht se cila është Shqipëria dhe pse duhet ta duan ata...", thoshte Robin Hanbury-Tenison në shtator të 2007-ës, kohë kur nga Thethi nisi aventurën e tij.

Në çdo faqe të këtij libri ndihet dashamirësia dhe mikpritja e popullsisë rurale, e cila hapi për Tenisonin dhe ekipin e tij, dyert e shtëpive, u ofruan atyre bukë të ngrohtë, djathë të bardhë të kriposur, dhallë dhe raki. Kështu që sjellja

fodulle e ministrit, tretet dhe harrohet tek lexon më se 200 faqet e tjera, të shkruar me dashuri për Shqipërinë e shqiptarët.

Në rrugëtimin e tyre në viset shqiptare, Theth, Valbonë, Lurë, Martanesh, Voskopojë, apo Shkodër, Librazhd, Korçë, Gjirokastër, Tepelenë e deri në skajet jugore, Robin Hanbury - Tenison dhe gruaja e tij u shoqëruan nga regjisori amerikan Mickey Grant, i cili gjatë gjithë kohës fiksoi në kamera aventurën e tyre.

Me materialin e përzgjedhur ata realizuan filmin dokumentar "Vendi i Shqiptonjave", me të cilin konkurruan para disa vitesh edhe në seksionin e dokumentarëve në Festivalin e Kanës.

Nuk e kam parë këtë film. Ndaj dhe nuk e di nëse në të është përfshirë sjellja e ministrit të Kulturës. Gjithsesi, edhe nëse është përfshirë, mendoj se tërë ai shtegtim i gjatë, gjithë ajo mikpritje e ngrohtë që ata prekin dhe ndiejnë në çdo hap nëpër Shqipëri, e bëjnë atë ministër tejet të vockël, në vogëlsinë, fodullëkun dhe mosmikpritjen e tij.

Libri i Tenison-it u shtohet zërave që

promovojnë sot Shqipërinë turistike, një vend i njohur më së pari përmes shënimeve të udhëtarëve të shekujve të shkuar, por njëkohësisht i panjohur e i pashkelur për shkak të izolimit 50-vjeçar.

Një letër falënderimi dhe ndjesë për autorin e këtij libri

Autori i këtij libri e kishte krijuar përfytyrimin e tij për Shqipërinë para se të vinte në këtë vend. Këtë gjë e dëshmojnë citimet që u bën mëse 20 autorëve të tjerë që kanë kaluar nëpër Shqipëri dhe kanë shkruar rreth Shqipërisë. Shënimet e udhëtarëve si Edith Durham, Lord Bajron, Martin Leak e kanë intriguar së tepërmi autorin dhe këtë e shpreh në mënyre mjaft të sinqertë në faqet e librit.

Nuk e di se ku është, dhe se çfarë po bën aktualisht 'ministri shqiptar i Kulturës, i vitit 2007' (ai që Tenison përshkruan në libër), por gjithsesi këshilla ime është që këtë libër ta lexojë së paku Këshilltari për Kulturën i Kryeministrit të Shqipërisë dhe t'i sugjerojë Kryeministrit, t'i

shkruajë Robin Hanbury-Tenison një letër
falënderimi për botimin e këtij libri, si dhe t'i
kërkojë atij ndjesë për sjelljen e padenjë të
'Ministrit të Kulturës, të vitit 2007'.

29.07.2018



Si iu dhurua Hrushovit,
kostumi i Preng Bibë Dodës?

*...do të ishin me dhjetra mijëra turistë
francezë që do ta vizitonin
këtë muze (të munguar) të Bib Dodës.*

*...nëse do t'i përdornim këto muze
(të munguara), për nxitjen e industrisë
së turizmit, do të kishim edhe më
shumë turistë të kulturës dhe historisë.*

*Napoleoni i III, u bë kumbari i djalit
të vetëm të Preng Bib Doda, Prengës.*

*Napoleoni, i dhuroj
një prej shpatave të tij, me të cilën i biri,
Prenga, ka pozuar me krenari
në disa fotografi, i veshur me kostumin
kombëtar shqiptar.*

*Ndërkohë, në kryeqytetin shqiptar,
Hrushovi ka marrë
dhuratë nga Enver Hoxha
një kostum tradicional shqiptar
i veshur nga Preng Bib Doda.*

Napoleoni i III (1808 - 1873) ka qenë kumbari i Preng Bib Dodës. Këtë fakt e mësova veç disa muaj më parë. Një kolegu im, lektor i lëndës së Gjenealogjisë në Universitetin Kombëtar të Irlandës në Galway, në pushimin mes seancave të një konference kushtuar Napoleonit të III, më tha: - A ka në Shqipëri një muze kushtuar Bib Dodës?

Nuk jam i sigurtë, - i thashë - por nuk besoj të ketë.

Atë mbrëmje, pas konferencës u takuam sërish. Ai më foli gjatë dhe gjithë pasion rreth

historisë së Bib Dodës dhe faktit se si Napoleoni i III u bë kumbari i djalit të vetëm të tij, Prengës. Napoleoni i dhuroj atij edhe një prej shpatave të tij; shpatë me të cilën i biri, Prenga, ka pozuar me krenari në disa foto të tij, i veshur me kostumin kombëtar shqiptar.

Në ditët në vijim nisa të gërmoj në bibliotekën e Universitetit dhe në internet për të gjetur diçka më shumë rreth këtyre fakteve. Punët e ngjeshura të përditshmërisë, ma bënë ta lë pas dore këtë kërkim. Por fatmirësisht, krejt papritur një tjetër koleg që jep lëndën e Historisë së Rusisë, më flet disa javë më vonë, rreth vizitës së Hrushovit në Shqipëri. Madje ai më tregon edhe për një pemë që Hrushovi ka mbjellë në kryeqytetin shqiptar, dhe një dhuratë që Hrushovi ka marrë nga Enver Hoxha. Kjo dhuratë ishte një kostum tradicional shqiptar i veshur nga Preng Bib Doda.

Preng Bib Doda, ka qenë Princi i Mirditës. Ai lindi në Orosh të Mirditës në vitin 1858 në familjen e Gjomarkajve. Gjomarkajt ishte autoriteti më i lartë i pleqërimit të kodit zakonor shqiptar (Kanunit) në Gegëri dhe prijësit tradicional të Mirditës.

Ai ishte një ndër drejtuesit kryesor të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Komandant i Lidhjes së Shkodrës dhe komandant i forcave mirditore e shkodrane që luftuan në mbrojtjen e Hotit e Grudës nga malazezët në vitin 1880.

Kandidat për fronin mbretëror të Shqipërisë në vitin 1914, dy herë zëvendëskryeministër dhe dy herë ministër. Ndër figurat më të shquara të kombit shqiptar, me një kontribut të jashtëzakonshëm në drejtimin e kryengritjeve për liri e pavarësi! U vra më 22 mars 1919, në Zejmen të Malësisë së Lezhës.

Pas vrasjes së Preng Bib Dodës, për një periudhë të shkurtër Mirdita, u drejtua nga e shoqja, Luçia. Më pas, parinë e Mirditës e mori kapërdan Marka Gjoni, po nga familja e Gjomarkajve. Këto fakte nuk kanë ndonjë peshë apo rëndësi të veçantë në historinë e një vendi. Por, nëse do t'i përdornim këto muze (të munguara), vende, madje dhe pemë, për nxitjen e industrisë së turizmit, ato do të luain një rol jo të vogël në thithjen e turistëve të kulturës dhe historisë; turistë të cilët këto vitet e fundit janë kthyer në trend në gjithë botën. Do ishin me

dhjetra mijëra turistë francezë që do ta vizitonin këtë muze (të munguar) të Bib Dodës.

Dhe, po aq, në mos me shumë rusë, që do vizitonin këtë pemë, ndofta tani e prerë për t'i lëshuar vendin ndonjë pallati shumëkatësh... .

Pse e shkruajta këtë histori

Këto shënime të shkruara nxitimthi në laptopin tim muaj më parë do kishin fjetur aty gjatë, ose mund të kishin humbur krejt pas disa viteve, po të mos ma nxisite kureshtjen rreth kësaj teme nje shkrim brilant i mikut tim nga Kosova, Profesor Nexhmedin Spahiu.

Ja çfarë shkruan ai ndër të tjera në shkrimin e tij të botuar para pak ditëve me titull: *Katolikët e Mirditës me Sulltan Muratin I kundër princit Llazar.*

Kur më 28.06.1389 u zhvillua Beteja e Kosovës, shqiptarët u rreshtuan në të dy palët kundërshtare. Derisa Balshajt morën pjesë në anën e princit Lazar Hrebljanoviq, mirditorët - me kapëdanin e tyre - u rreshtuan në krahun e Sulltan Muratit I. Meqë osmanët e fituan luftën,

për këtë mirditorëve iu garantua autonomia, të cilën e gëzuan deri në shekullin XIX. Mirditorët nuk paguan fare taksa dhe qeveriseshin me kanunin e maleve, ndërsa i vetmi detyrim i tyre ndaj Sulltanit ishte që të shkonin në luftë kurdo që të kishte nevojë, me ç'rast u takonte plaçka e luftës.

Bib Doda dhe Lufta e Krimesë

Rasti me i njohur i pjesëmarrjes së mirditorëve në luftërat osmane ishte Lufta e Krimesë (1853-1856) kur roli i 5.000 luftëtarëve në krye me kapedanin Bib Doda (1820-1866) ishte vendimtar në fitoren e betejës.

Ashtu si e shpjegon romancieri i parë shqiptar, Dom Ndoc Nikaj (1865-1951), që ishte i biri Gjokë Jake Nikajt, njërit prej këtyre luftëtarëve të Bib Dodës, kur ushtritë osmane, angleze e franceze ishin duke u mundur nga ushtria ruse në betejën kryesore, mirditorët - duke mos përfillur qoftë më të voglin rregull ushtarak, duke rrezikuar jetën e tyre në maksimum - i shkaktuan habi ushtrisë ruse dhe e thyen atë.

Për rrjedhojë, Sulltan Abdylmexhiti I (sundoi në periudhën 1839-1861) i dha Bib Dodës titullin Pashë, ndërsa Perandori i Francës, Napoleoni III (sundoi në periudhën 1852-1870) u bë kumbar i djalit të vetëm të Bib Dodës, Prenkut (1860-1919).

02.09.2018



Rexh Meta dhe kushti
i Enverit
për Rose Wilder Lane

*...shqiptari i parë që diplomohet me
medalje të artë në Universitetin e
Kembrixhit, shoqëroi gazetaren
amerikane më të paguar në botë,
gjatë periudhës së pas
Luftës I Botërore, Rose Wilder Lane.
Kushti i Enver Hoxhës për gazetaren,
pasi e dënon Rexhë Metën me vdekje.*

*Nuk e di, nëse dikush
është kujtuar ta vlerësojë apo dekorojë
këtë figurë kaq të madhe.*

*Nuk e di, nëse dikush është kujtuar të
shkojë tek i biri, nipi apo dikush tjetër
që jeton prej familjes,
për të shfletuar dorëshkrimet e tij.*

*Rexh Meta, meriton
një shtatore në Tiranë.*

*Për më tepër, të mos harrojmë
se ai ka shoqëruar një nga gazetaret
më në zë të botës për kohën.*

Rexh Meta (1906-1985), nga një banor i Jetimorese së Shkodrës, bëhet shqiptari i parë që diplomohet me medalje të artë në Universitetin e Kembrixhit.

Kjo falë fatit, aftësive dhe shoqërimit që ai bën gazetares amerikane më të paguar në botë, gjatë periudhës së pas Luftës së Parë Botërore, Rose Wilder Lane.

Rexh Meta dënohet me vdekje nga Enver Hoxha. Por, gazetarja, shkrimtarja dhe antro-

pologia Rose Wilder Lane, sapo e mëson këtë fakt, ndërhyt gjer te Presidenti i SHBA për t'ia shpëtuar jetën atij.

Enver Hoxha pranon t'ia falë jetën Metës, por me kusht që Rose Wilder Lane, që kishte një prestigj dhe influencë të jashtëzakonshme në mbarë botën, të mos fliste kundër regjimit komunist në Shqipëri.

Lane e pranon kushtin e, për rrjedhojë, Rexh Metës i falet jeta. Por ai mbahet në burg për shumë vite, e më pas në internim, derisa vdes diku në afërsi të Tiranës, në të njëjtin vit që vdes dhe Enver Hoxha.

Po kush ishte Rexh Meta?

Babai i Rexhës, Metë Fazlia, bashkë me disa familjarë të tjerë, në vitin 1913 largohet nga Vuthajt për të shpëtuar familjen nga gjenocidi që u bëhej shqiptarëve në krahinën e Plavës dhe Gucisë nga forcat malazeze.

Pasi shkojnë për disa vite në Kosovë, në vitin 1919, Metë Fazlia me djalin, Rexhën dhe dy vajzat, Gjyken dhe Zojën, kthehen dhe jetojnë në

Shkodër. Aty, Metë Fasllia dhe gruaja e tij vdesin, kështu që Rexha dhe dy motrat e tij strehohen në Jetimoren e Shkodrës, që varej nga Kryqi i Kuq Ndërkombëtar.

Rexha aty nis shkollimin dhe mëson në mënyrë të shkëlqyer gjuhën angleze. Që 12 vjeç fillon të shoqërojë ekspeditat anglo-amerikane në Veri të Shqipërisë si përkthyes. Por, ekspedita që i ndryshoi jetën këtij djaloshi, ishte ajo që udhëhiqej nga Rose Wilder Lane. Ajo u kujdes për të (disa burime thonë se ajo e birësoi Rexhën) dhe i siguroi bursën për në shkollën teknike "Harry Fultz" në Tiranë.

Lane e dërgoi Rexhë Metën më pas në Universitetin e Kembrixhit në Angli, në Fakultetin e Financave, të cilin Rexh Meta e kreu me sukses duke mbrojtur në vitin 1937 edhe temën e doktoraturës në lëmin e ekonomisë financiare. Në Librin e Artë të Universitetit të Kembrixhit gjendet edhe emri i shqiptarit Rexhë Meta.

Më 1938-n ai kthehet në Shqipëri dhe fillon punën si drejtor i Drejtorisë së Financave të

Shqipërisë. Dy vjet me pas internohet në Itali, ku qëndron deri në verën e vitit 1943. Pastaj, kthehet në Shqipëri dhe në shtator të po këtij viti merr pjesë në mbledhjen themeluese të Lidhjes së Dytë të Prizrenit, si një nga 45 përfaqësuesit e kësaj lidhjeje, përkrah figurave të tilla, si: Ismet Boletini, Xhafer Deva, Shaban Polluzha, Rexhep Mitrovica, Marie Kraja e patriotë të tjerë.

Pas Luftës, Rexh Meta arrestohet nga pushteti komunist në Shqipëri dhe dënohet me vdekje. Rose Wilder Lane e mëson këtë lajm dhe ndërhyt deri te Presidenti i SHBA që atij t'i falet jeta.

Enver Hoxha vë kushte. Lane, për hir të jetës së Rexh Metës, e pranon kushtin dhe dënimi i tij shndërrohet me 27 vjet burg. Ai e kreu dënimin në qelitë e Burgut të Burrelit. Familja e Rexhës, gruaja Pertefi, djali Fitimi dhe vajza Bora, përjetuan vuajtje, persekutim dhe mjerim ekstrem.

Rexh Meta vdiq afër Tiranës në vitin 1985 (vit në të cilin vdiq dhe Enver Hoxha). Trupi i tij u varros në Shkodër.

Një shtatore për Rexhën dhe Rose Wilder Lane

Nuk e di nëse dikush është kujtuar ta vlerësojë apo dekorojë këtë figurë kaq të madhe. Nuk e di nëse dikush është kujtuar të shkojë tek i biri, nipi apo dikush tjetër që jeton prej familjes, për të shfletuar dorëshkrimet e tij.

Sikur asgjë të mos ketë bërë Rexh Meta në jetë, veç fakti se ai ishte shqiptari i parë që është diplomuar në Kembrixh me medalje të artë, ai e meriton një shtatore në Tiranë.

Për më tepër, të mos harrojmë se ai ka shoqëruar një nga gazetaret më në zë të botës për kohën.

Rose Wilder Lane, e cila ka bërë për Shqipërinë më shumë, se shumë e shumë shtetarë shqiptarë. Jeta e Rexhë Metës meriton të shkruhet. Ashtu siç e meriton të rivlerësohet dhe vihet në piedestalin shqiptar që meriton Rose Wilder Lane.

Mendoj se Ministria e Kulturës bën më mirë të akordojë fonde për libra e dokumentarë rreth këtyre figurave të ndritura të historisë së

Shqipërisë, sesa për ca programe televizive, libra apo aktivitete surrogate, të cilat nuk po i përmend me emër pasi nuk kam asnjë dëshirë apo nevojë të bëj armiq.

30.09.2018



Ndoshta e Treta... sepse
Lidhja e Dytë e Prizrenit është
mbi 70 vjeçare dhe ka histori

*... nëse Edi Rama e Hashim Thaçi
tentuan ta trumbetojnë mbledhjen e
përbashkët të qeverive që kryesonin,
si Lidhja e Dytë e Prizrenit,
duhej së paku ta etiketonin atë
mbledhje rutinë të 11 Janarit 2014,
me termin "...e Tretë".*

*Qëllimi i këtij shkrimi nuk është
aspak analiza apo gjyqimi i mbledhjes
rutine mes qeverisë Shqiptare dhe
Kosovës, por të informojë rreth fatit
tragjik të Lidhjes së Dytë të Prizrenit
mbajtur më 16 -20 Shtator 1942.*

*Veprimtaria e saj, u shtyp
dhunshëm me pushtimin e Kosovës
nga Jugosllavia e Titos. Komunistët
serb, malazez e shqiptar vranë e
masakruan me mijëra nacionalistë
të Kosovës dhe Shqipërisë.*

Etiketimi euforik që i patën bërë një mbledhjeje të përbashkët të qeverisë Shqiptare dhe asaj të Kosovës, mbajtur me 11 Janar 2014, si 'Lidhja e Dytë e Prizrenit', përbën më së pakti një falsitet në aspektin e historiografisë shkencore. Kjo për faktin e thjeshtë se pas Lidhjes së Parë të Prizrenit me 1878, Lidhja e Dytë e Prizrenit është mbajtur nga 16-20 Shtator 1943. Këto janë fakte historike që i përkasin të shkuarës, dhe siç e ka thënë poeti i lashtë grek,

Agathon, që 400 vjet para lindjes së Krishtit, "As vetë Zoti nuk ka fuqi ta ndryshojë të shkuarën". Kështuqë shtypi dhe mediat e kontrolluara nga Edi Rama apo Hashim Thaçi, të dehur me euforinë e tyre megalomane, duhej që së paku ta etiketonin atë mbledhje, nëse dëshironin, 'Lidhja e Tretë e Prizrenit'.

Qëllimi i këtij shkrimi nuk është aspak analiza apo gjykimi i asaj mbledhje rutine mes qeverisë Shqiptare dhe asaj të Kosovës, por të informojë lexuesin rreth fatit tragjik të Lidhjes së Dytë të Prizrenit të mbajtur, prej 16 deri më 20 Shtator 1942.

Pas shembullit pozitiv të Lidhjes së Parë të Prizrenit më 1878, të mbajtur në qytetin me të njëjtin emër, me ndihmën dhe përkrahjen e Perandorisë Osmane, në situatën e re të krijuar gjatë Luftës së Dytë Botërore, lindi nevoja imediatë e thirrjes së Lidhjes së Dytë të Prizrenit. Kjo pasi fati dhe interesat e shqiptarëve të Kosovës ishin të kërcënuara seriozisht.

Disa nacionalistë shqiptarë në Kosovë dhe Shqipëri, me mbështetjen e autoriteteve

Gjermane të kohës, hartuan në mbledhjen e kësaj Lidhje një platformë për mbrojtjen e kufijve etnike shqiptare; kufij që ishin realisht të kërcënuar nga shovinistët serbo-malazeze të Drazho Mihajeviçit dhe brigadave mikse sllavo-komunistë të disa shteteve sllave (serb, malazez, maqedonas, e bullgar). Por fatkeqësisht, aktiviteti i kësaj Lidhjeje, u shtyp dhunshëm dhe shumë shqiptare u vranë apo u zhduken.

Historiografia Shqiptare dhe ajo e ish-Jugosllavisë deri në vitin 1990, e kanë paraqitur ushtrinë gjermane si shkatërrimtare për fatin e Kosovës, por realisht gjatë kësaj periudhe Kosova përjetoi një liri, e cila për fat të keq nuk zgjati shumë. Është i njohur fakti se gjermanët, me përjashtim të zonës së minierave të Mitrovicës, u tërhoqën shpejt duke e njohur Kosovën si pjesë të Shqipërisë.

Dy muaj e gjysëm para se të mblidhej Lidhja e Dytë e Prizrenit, pikërisht më 7 korrik 1943, në Kosovë u shpall shtetrrëthimi. Çetat çetnike serbe e malazeze, në tragjedinë e Bihorit, masakruan barbarisht 4000 shqiptarë të pafajshëm. Për t'i bërë ballë kësaj situatë në

Kosovë u bë domosdoshmëri krijimi i një organizmi për të ndalur këtë revansh e këto masakra.

Në rrethanat e reja të krijuara pas kapitullimit të Italisë disa njësitë shqiptare, të ndihmuara prej disa formacioneve të vogla ushtarësh gjermanë (të ardhur nga Mitrovica) morën në dorëzim administratën lokale të Kosovës, duke formuar Këshillat Autonome Ekzekutive. Ndërkohe çetat e ashtuquajtura "çlirimtare" komunistë në Kosovë, luftonin me të gjitha mjetet për minimin e punës atdhetare të këtyre Këshillave Autonome Ekzekutive, duke mbjellë frymën e vëllavrasjes midis shqiptarëve, ashtu siç kishin bërë në shume zona të Shqipërisë.

Më 11 shtator 1943, me nismën e një grupi nacionalistësh të përbërë nga ing. Xhafer Deva, Musa Shehu, Sheh Hasani, Asllan Boletini, Tahir Zajmi, Luke Simon Mjeda, Qazim Bllaca dhe Pjetër Vuçaj, u zhvillua në Prizren një mbledhje, ku u shqyrtua situata e krijuar dhe nevoja imediate e nismave urgjente që duheshin marrë, për përballimin

e situatës. Tri ishin pikat bazë të kësaj mbledhje:

1. Thirrja e një Lidhjeje me frymën e Lidhjes së Parë të Prizrenit, ku do të përfaqësoheshin të gjitha krahinat e Kosovës, Dibrës, Strugës, Tuzit, Ulqinit me delegatë të zgjedhur nga populli.

2. Krijimi i një Keshilli Autonom Ekzekutiv që do vepronte deri sa të zgjidhej një autoritet legjitim nga Mbledhja e Përgjithshme e kësaj Lidhjeje. Kjo me qëllim për të mbajtur qetësinë, rendin publik dhe bërë ballë situatave të reja që mund të krijohen në terren.

3. Këshilli Ekzekutiv i kësaj mbledhjeje do të merrej me përgatitjen e Mbledhjes së Kuvendit, pra të Lidhjes së Dytë të Prizrenit, hapja e të cilës do të bëhej jo më vonë se më 16 shtator 1943.

Kështu pra më 16 shtator 1943 në mesin e shkollës "Bajram Curri", në Prizren filloi punimet Lidhja e Dytë e Prizrenit. Kjo lidhje zgjodhi Musa Shehun kryetar, Aqif Blutin n/kryetar, Prof. Rexhep Krasniqin n/kryetar e Bedri Gjinajn sekretar. Këtu u miratuan 6 pikat

e rendit të ditës, të cilat në thelbin e tyre të përbashket kishin bashkimin e trojeve etnike. Në fund u zgjodhën Rexhep Mitrovica kryetar, Musa Shehu n/kryetar, Prof.Kolë Margjini n/kryetar, dhe Sheh Hasani, Asllan Boletini, Tahir Zajmi, Qazim Bllaca, anëtarë.

Ishte 21 shtator 1943, kur delegatët shkuan në selinë e Lidhjes së Parë të Prizrenit të 1878, dhe atje nënshkruan vendimet që Lidhja e Dytë e Prizrenit kishte marrë. Statuti i Organizatës së Lidhjes së Dytë e Prizrenit, kishte 22 nene, të ndarë në disa pika.

Veprimtaria e kësaj Lidhjeje u shtyp dhunshëm me pushtimin e Kosovës nga Jugosllavia e Titos. Por, është i njohur fakti se përpjekjet dhe luftimet e çetave nacionalistë që vepronin në kuadër të kësaj Lidhjeje nuk kanë pushuar deri në vitin 1945. Komunistët serb, malazez e shqiptar që vepronin së bashku vranë e masakruan me mijëra nacionalistë të Kosovës dhe Shqipërisë që vepronin në kuadër të kësaj Lidhjeje.

Numri i nacionalistëve të pushkatuar mbas pushtimit sllavo-komunist të Kosovës, arriti mbi

20.000 vetë, duke përfshirë këtu drejtuesit dhe organizatorët e kësaj Lidhjeje si, Musa Shehu, Prof.Kole Margjini, Aqif Bluta, Bedri Peja, Asllan Boletini, Qerim Begolli, Xhevat e Rifat Gegolli, Shyqyri Bej Ramadani, Mustafa Agushi, Sulejman Xhemal Prishtina, Sulejman Ashiku, Av. Esad Berisha, Faik Okllapi, Aqif Tetova, Isak Taniku, Av. Shaban Kamberi, Xhem Gostivari e qindra të tjerë në viset e ndryshme të Kosovës e Maqedonisë.


Edhe ato pak nacionalistë që mundën të largohen nga Kosova duke shkuar në Shqipëri, regjimi i Enver Hoxhës, nuk ngurroi t'i kthejë të gjithë tek autoritetet Jugosllave, ku u pushkatuan pa gjyq. Të tillë ishin Kolonel Fuat Dibra, Kolonel Asllan Vela, n/kryetar Sidki Shkupi, Major Hasha, Kapiten Hajdar Planeja, Kapiten Rasim Dajç, kapiten Hysni Rudi, kapiten Gjon Deshtanishta, kapiten Mark Thani, toger Musli Dobruna, n/toger Qazim Gostivari e aspirant Reshit Kaçaniku.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore njësitet e ushtrisë shqiptare që shkuan në Kosovë, në vend që të bashkonin forcat me njësitet nacionalistë të kësaj

Lidhjeje dhe të luftonin kundër atyre që po vrisnin shqiptarët e Kosovës; bënë të kundërtën, vranë me qindra e mijëra shqiptarë, nacionalistë. Dhe të gjithë këtë gjakderdhje e bënë për ideologjinë komunistë.

Ky pra, qe fati i Lidhjes së Dytë të Prizrenit. Kështu nëse Rama e Thaçi tentuan ta trumbetojnë mbledhjen e përbashkët të qeverive që kryesonin si Lidhje të Prizrenit, duhej që për hir të të gjithë nacionalistëve që organizuan dhe drejtuan Lidhjen e Dytë të Prizrenit dhe që dhanë jetën për idealin kombëtar, së paku ta etiketonin atë mbledhje rutinë të 11 Janarit 2014, me termin Lidhja e Tretë e Prizrenit.

14.10.2018



Sikur të bënim modelin irlandez për historinë!

*...cilido kryeministër shqiptar,
do bënte punën më të mençur, po t'i
akordonte fondet, materialet dhe
infrastrukturën e nevojshme një
universiteti të mirënjohur në
Britaninë e Madhe, Gjermani apo
SHBA, për të shkruar tekstet bazë
të historisë së Shqipërisë.*

● —————

*Sa herë që do ndërrohen partitë në
pushtet, do të rishkruhen tekstet e
historisë së Shqipërisë
sipas orekseve të politikës së çastit.
Për fat të keq, ky rishkrim do të prekë
jo vetëm kapitujt e historisë së katër
apo pesë shekujve të fundit, por do
shtrihet deri në epokën e gurit.
Sepse, këta historianë shqiptarë të
paguar, dhe me lidhje personale apo
farefisnore me politikën qeverisëse, nuk
mund të jenë kurrësi objektivë.*

————— ●

Kolë Bibë Mirakaj (1899 - 1968), ka punuar mësues, kryetar komune gjatë qeverisjes së Fan Nolit dhe Ministër i Brendshëm në periudhën Maj - Shtator 1943. Jeta e këtij Nolisti, "fashisti", intelektual dhe atdhetari të shkëlqyer meriton të rishkruhet. Kjo për shkakun e anatemimit të pamërituar që i është bërë atij për më se pesëdhjetë vjet. Në vitin 1943, kur forcat gjermane po mbërrinin në Shqipëri, Kolë Bibë Mirakaj ishte Ministër i Brendshëm. Në atë kohë një numër i

PREFECTURË

Tirana

Intend q' te kështjësve Rafael Salas e Salas
Kështjës me gjith famijet e tyre t'ua lëshohet me t'ua heq
pasaportë për 'shkollë n'Itali.

PREFECTURA MONTENEGRO
- TIRANE -
Shkruan me 22/11/1943
Prot. Nr. 1266

MINISTRI
[Signature]

L. 7
Pasaportë për kështjësve
Pasaportë për kështjësve
Pasaportë për kështjësve
31/11/43

TELEGRAM

SHIFRË

PREFECTURAVE
DIREKTORIS PËRQJITËRIS POLICIE

Teletogram
TIRANË

Intend q' gjithë shprehje nënkuptet shprehje
q' shprehje pasaportë për Itali, t'ua lëshohet pa u shpall
asnjë pengim për vende dhe për famijet e tyre.
Te përshiten kështjës q' te shprehjeve
q' te formalitet, shprehje pasaportë k' te vendet te repartit
politike.
Për vistic nga Delegacioni Italian t'antere-
shmit kështjësve.

MINISTRI
[Signature]

Pasaportë për kështjësve
Pasaportë për kështjësve
Pasaportë për kështjësve
31/11/43
Pas.

konsiderueshëm hebrenjsh ndodhej në territorin shqiptar. Jeta e tyre ishte në rrezik serioz nga nazistët gjermanë. Por çfarë bëri Kolë Bibë Mirakaj, për t'u shpëtuar jetën këtyre hebrenjve.

Dy faksimilet e bëra të njohura nga Dr. Nevila Nika dhe Faik Quku, autori i librit "Qëndresa Shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botnore" (1941-1944) që po i ribotojmë flasin vetë.

Një urdhër i tij, i datës 31 gusht të vitit 1943, detyronte pajisjen me pasaporta shqiptare për të gjithë hebrenjtë që ndodheshin në territorin e vendit tonë në atë kohë.

Përmes pasaportave shqiptare ata mund të udhëtonin e të gjenin strehim në Italinë jugore, pjesë e çliruar në atë kohë prej forcave aleate anglo-amerikane.

Me këtë gjest Kolë Bibë Mirakaj u shpëtoi jetën mbi 2000 hebrenjve që ndodheshin në Shqipëri të cilët u pajisën me pasaporta shqiptare dhe udhëtuan drejt Italisë. Këto fakte shprehin nevojën urgjente të rishkrimit jo vetëm të historisë së jetës së Kolë Bibë Mirakajt por të krejt historisë së Shqipërisë. Thënë me

saktë, shprehin domosdoshmërinë për të pasur një tekst realist të historisë së Shqipërisë. Tekst i cili mund dhe duhet patjetër të jetë jashtë ndikimeve politike, qoftë në trajtimin e këtyre 30 viteve demokraci, ashtu dhe në trajtimin e së shkuarës sonë diktatoriale, monarkike apo dhe asaj koloniale.

Shqipëria ka gati 30 vjet që jeton në demokraci. Po të mos ekzistonin reminishencat e sjelljeve autoritare apo servilizmat ndaj politikave të çastit, të drejtuesve të institucioneve përgjegjëse për tekstet e historisë, këto gati tre dekada do të ishin mëse të mjaftueshme për ta zgjidhur përfundimisht këtë çështje. Por kjo çështje fatkeqësisht nuk u zgjidh.

Ne dhe Europa Lindore

Nuk dua të bëj këtu analizën e faktorëve që e kanë penguar këtë proces në Shqipëri. Por dua të nënvizoj faktin se shumë shtete të Europës Lindore që e përjetuan regjimin komunist e kanë zgjidhur këtë çështje. Metodrat dhe institucionet që u përfshinë në rishkrimin

e teksteve të historisë së tyre janë nga më të larmishmet. Nuk është rasti t'i rreshtoj këtu. Por një gjë është e vërtetë: ato kanë folur më pak se ne për këtë çështje, dhe kanë punuar shumë më shumë se ne.

Ndofta ne si reminishencë të së shkuarës kemi sindromën e të folurit shumë dhe të punuarit pak. Po rreshtoj disa mendime si mund të zgjidhet kjo çështje.

A mund të adoptohet në Shqipëri modeli irlandez?

Modeli irlandez mendoj se do të ishte i përshtatshëm për një vend si Shqipëria. Irlanda ka përjetuar një pushtim gati 700 vjeçar nga Anglia.

Tekstet e historisë se këtij vendi nga vitet 1922-1923 e deri në mesin e viteve 1960 kanë vuajtur nga patetizmat, megalomanitë dhe shabllonizmat në favor rrymave nacionaliste, apo nga e kundërta e tyre, në mënyrë ekstreme.

Sa herë ndërronin partitë në pushtet

ndërronin edhe tekstet e historisë, rishkruheshin ngjarjet sipas orekseve të politikës së çastit etj. (tamam si në Shqipëri në këto 30 vitet e fundit).

Aty nga mesi i viteve '60, Parlamenti mori një vendim, dhe qeveria akordoi fonde, të cilat iu dhanë Universitetit të Oxfordit për të shkruar tekstet e historisë së Irlandës. Këto tekste shërbyen si tekste bazë për shkollat fillore dhe të mesme, ndërkohë që në shkollat e larta u lejuan dhe lejohen përveç këtyre teksteve edhe tekstet alternative.

Por, gjatë gjithë kësaj periudhe, asnjëri nuk pengoi, apo dhe nuk pengon, asnjë historian të majtë apo të djathtë të shkruajë e botojë tekste historie sipas oreksit apo bindjeve që ka.

Çfarë gjelle mund të na gatuajnë
historianët e komanduar nga politika?

Personalisht, mendoj se Edi Rama, apo cilido kryeministër shqiptar, do bënte punën më të mençur po t'i akordonte fondet, materialet dhe infrastrukturën e nevojshme një universiteti të

mirënjohur në Britaninë e Madhe, Gjermani apo SHBA, për të shkruar tekstet bazë të historisë së Shqipërisë.

Kam bindjen më të plotë që, po t'i pajisë Edi Rama me fonde, materiale dhe infrastrukturë të bollshme institucionet që merren me shkrimin e historisë sot, Basha nesër, apo kushdo tjetër qoftë Kryeministër i së Djathtës, do të japë prapë fonde të tjera, për këto institucione, të drejtuar nga të tjerë drejtues, për t'i rishkruar nga e para.

Kështu, sa herë që do ndërrohen partitë në pushtet, do të rishkruhen tekstet e historisë së Shqipërisë sipas orekseve të politikës së çastit. Për fat të keq, ky rishkrim do të prekë jo vetëm kapitujt e historisë së katër apo pesë shekujve të fundit, por do shtrihet deri në epokën e gurit. Sepse, këta historianë shqiptarë të paguar, dhe me lidhje personale apo fafëfisnore me politikën qeverisëse, nuk mund të jenë kurrësi objektivë.

E them këtë, pasi për arsye dhe motive të panumërta, shqiptarët nuk janë çliruar ende nga zelli i të shërbyerit verbërisht dhe as nga

vetëmburrja (në kuptimin e asaj që thonë se "jam unë ai që i di gjërat më mirë se ti").

Shqipëria, si çdo komb tjetër i qytetëruar, e meriton t'i ketë tekstet e historisë së saj të shkruara në mënyrë objektive dhe shkencore.

Ndërgjegjja profesionale e historianëve shqiptarë, për njëmijë e një arsye, nuk e ka arritur ende atë stad për t'i shkruar këto tekste me paanësi, dhe larg vesit të të shërbyerit ndaj politikës qeverisëse me pasion dhe verbërisht.

Kjo është arsyeja, pse mendoj që adoptimi i modelit irlandez është më i përshtatshmi.

09.12.2018



Meave de Burgh
agjentja sekrete britanike
që admironte shqiptarët

*...e vetmja grua, ende gjallë,
që ka punuar si agjente në
shërbimin e fshehtë anglez,
gjatë kohës që ky shërbim stërviste
të rinj nacionalistë shqiptarë
në mërgim, me qëllimin për t'i
dërguar me mision në Shqipëri
për rrëzimin e regjimit komunist.*

● —————

*Meave de Burgh, flet me mjaft respekt
e simpati për ata të rinj, flet për
ndjenjat e larta nacionaliste të tyre, për
inteligjencën dhe përkushtimin në
përmbyshjen e detyrave të ngarkuara,
etj. Por, sytë e saj mbushen me lot kur
ajo sjell në memorie një natë tragjike
ku humbën jetën gati 300 prej tyre,
në një aksion që dështoi,
për shkak të rrjedhjes së informacionit
përmes dubël agjentit Kim Philby.*

————— ●

Meave de Burgh jeton vitet e pleqërisë në Wexford të Irlandës. Ajo është ndofta e vetmja grua, ende gjallë, që ka punuar si agjente në shërbimin e fshehtë anglez, gjatë kohës që ky shërbim stërviste të rinj nacionalistë shqiptarë në mërgim, me qëllimin për t'i dërguar me mision në Shqipëri për rrëzimin e regjimit komunist.

Në rrëfimin e saj për kanalin më prestigjioz publik të Irlandës, RTE1, Meave de Burgh, tregoi rreth jetës së saj në Maltë, ku kishte punuar si shifrante në shërbimin e fshehtë anglez, ndërkohë që burri i saj Kolonel Charles Davison

dhe kolegët e tij, stërvisinin të rinj nga mërgata shqiptare për t'i dërguar me mision në Shqipëri. Në këtë intervistë, ajo flet me mjaft respekt e simpati për këta të rinj, flet për ndjenjat e larta nacionaliste të tyre, për inteligjencën dhe përkushtimin në përmbushjen e detyrave të ngarkuara, etj. Por, sytë e saj mbushen me lot kur ajo sjell në memorie një natë tragjike ku humbën jetën gati 300 prej tyre, në një aksion që dështoi, për shkak të rrjedhjes së informacionit përmes dubël agjentit Kim Philby.

Meave u intervistua nga ky televizion, për llogari të një emisioni mjaft të shikuar në Irlandë, të titulluar "Who Do You Think You Are?", emision që ka për qëllim të shpalosë para publikut irlandez rrënjët gjenealogjike të njerëzve të shquar. Ajo u intervistua si gjyshja e Rosana Davison, e cila pasi ka fituar Miss Bota disa vite më parë, tani është top-modelja më e bukur irlandeze.

Meave është e ëma e këngëtarit mjaft të mirënjohur të viteve '80-'90, Chris de Burgh. Ajo jeton vitet e pleqërisë së saj në këtë qytet të bukur turistik në lindje të Irlandës. Intervista e

saj u konsiderua si një zbulim interesant përsa i përket jetës së saj në këtë mision të shërbimit sekret anglez si dhe simpatisë së lartë që ajo shprehu për këta të rinj shqiptarë.

Shtypi irlandez i kushtoi vëmendje për disa



Ish agjentja e shërbimit të fshehtë anglez, Meave de Burgh është gjyshja e Rosana Davison, top-modelja irlandeze e cila vite më parë, ka fituar Miss Bota.

ditë radhazi deklaratave të saj rreth përpjekjeve të shërbimeve angleze dhe amerikane, për rrëzimin e regjimit komunist në Shqipëri, si dhe tragjedisë njerëzore që shkaktoi roli i dubël-agjentit Kim Philby.

Një ditë pasi u dha ky program në RTE1, i cili përmbante dhe intervistën e saj, si gjyshe e Rosana Davison, një kolegu im profesor i gjenealogjisë, më takon dhe më dhuron një DVD. Ai e kishte regjistruar këtë emision. Ai më tha se këtë DVD ua kishte vënë në një orë leksioni ta shikonin edhe studentëve të tij dhe se kishin diskutuar gati dhjetë minuta, rreth historisë së kësaj agjenteje dhe simpatisë së saj për Shqipërinë dhe shqiptarët. U ndjeva mirë, por edhe disi konfuz... Kur shkova në shtëpi, e vura atë DVD dhe e pashë sërish emisionin. Të nesërmen e futa në një zarf dhe ia dërgova një kanali televiziv në Tiranë, por nuk mora përgjigje.

Para disa muajsh u interesova për fatin e Meave de Burgh. Mësova se është ende gjallë...

30.12.2018



Imzot Kaçorri
përballë mbretit të
Austro-Hungarisë,
Franz Jozefi I

*...më 12 nëntor 1912,
Imzot Nikollë Kacori,
i dërgon memorandum, Mbretit
të Austro - Hungarisë, Franz Jozefit I,
ku i kërkon ndihmë që shteti shqiptar
mos të gllabërohet nga sllavët, grekët e
turqit dhe të njëjët shteti shqiptar
"në katër vilajetet e Shqypnisë me
Kosovë, Manastir, Shkodër e Janinë".*

● —————

28 Nëntor 1912. Pasi mbërrijnë atje shumica e delegatëve, në Vlorë mbahet Kuvendi i Pavarisë. Ismail Bej Vlora zgjidhet kryeministër dhe Ministër i Punëve të Jashtme, dhe Imzot Nikolle Kaçorri nënkryetar i Qeverisë.

Me që Ismail Bej Vlora u zgjodh edhe si Ministër i Punëve të Jashtme, pjesën më të madhe të kohës e kalonte jashtë Shqipërisë, lirisht mund të thuhet se Imzot Nikollë Kaçorri, luante rolin e kryeministrit.

————— ●

Askush nuk mund ta mohojë kontributin e vyer të Ismail Bej Vlorës në Shpalljen e Pavarësisë. Por janë të paktë ata që e dinë se pas aktit të Shpalljes së Pavarësisë ai qëndroi në Shqipëri gjithsejt 42 ditë. Duke mbajtur postin e Kryeministrit dhe Ministrit të Jashtëm, detyra ia donte, Ismail Bej Vlorës, të udhëtonte nëpër botë.

Pra për rrjedhojë i bie që (de facto) me

drejtimin dhe punët e asaj qeverie të jetë marrë Imzot Nikollë Kaçorri. Se si kanë rrjedhur punët më vonë për Kaçorrin, kjo dihet. Por dihet pak apo aspak rreth jetës dhe veprimtarisë së tij.

Informacione të bollshme rreth jetës dhe veprimtarisë atdhetare, të Imzot Nikollë Kacorrit, japin disa artikuj në Revistën "Leka", e cila dilte në Shkodër para periudhës së komunizmit.

Studimi më i plotë deri tani, besoj, është ai i Imzot Pren Kolës me titull "Imzot Nikollë Kaçorri për mëvehtësinë e Shqipërisë", i cili është botuar në revistën "Shpresa" të Prishtinës dhe "Zeri i Shën Nikollës" në Velezhë të Prizrenit.

Imzot Nikollë Kacorri u lind në vitin 1862 në fshatin Kre i Bajrakut të Lurës. Babai i tij ishte katolik, ndërsa nëna muslimane. Arqipeshkvi i Durrësit, Imzot Ambrosio pas një vizite që bëri në Lurë e mori me vete për ta përgatitur për meshtar.

Në vitin 1884, mbaroi studimet filozofiko - teologjike për meshtar dhe u shugurua po të

njejtin vit në Shkoder. Shërbeu në Delbnisht, pastaj u emërua famulltar ne Durrës. Papa i asaj kohe e nderoi me "Kryqin e artë", "Për Kishë dhe Papë". Po në këtë vit emërohet edhe Ipeshkv. Në vitet 1905 - 1907, drejtoi kryengritjen kundër turqve ne Kurbin.

Në vitin 1908 merr pjese në Kongresin e Manastirit së bashku me At Gjergj Fishtën e shumë atdhetarë të tjerë. Fal kontributit te tij dhe te disa klerikeve të tjerë katolike ne kete kongres kemi sot një alfabet latin dhe jo turk apo cirilik.

Imzot Nikollë Kacori mori pjesë në Kongresin e Elbasanit, i cili synonte të korigjonte imazhin negativ te Kongresit te Dibrës (korrik 1909) të organizuar prej xhonturqve.

Revista "Leka", flet edhe për gjyqin dhe dënimin me disa vjet burg dhe gjobë në të holla të Nikollë Kacorit, nga regjimi xhonturk i asaj kohe, lajme të cilat i boton dhe gazeta "Dielli".

Ja, si shkruan gazeta "Dielli" e datës 8.3.1911:
"Më 15 të Dhjetorit u kënduen në gjykatore

të Durrësit letrat që patën ardhur të prishura prej temizit të Stambollit, më 17 vazhdoi gjyqi përsëri por pa len shumë me fole të ndershmin prift atdhetar, dhe pa thirr njeri si dëshmitar.

E dënuan përsëri me dy vjet burg e 25 lira gjok. Avokati mbrojtës zoti Talib Efendi nga Gjirokastra kërkoi të zburgosurit e Don Nikoll Kacorrit, dhe e bëri temiz për së dyti por gjyqi nuk e liroi".

Imzot Nikoll Kaçorri ishte njeri nga arkitektët kryesor të bërjes së shtetit të ri Shqiptar. Memorandumi që ai i dërgon Mbretit të Austro-Hungarisë Franc Jozefit vetëm dy jave para se shpalljes së Pavarësisë e dëshmon këtë më së miri.

Sic dihet në fillim që vendosur që pavarësia të shpallej jo në Vlorë, por pikërisht në Durrës, në qytetin ku Imzot Nikolle Kaçorri zhvillonte veprimtarinë e tij.

Por autoritetet turke lajmëruan telegrafikisht komanden e Janinës dhe u përgatit me shpejtesi një njësi ushtarake turko-greke që me çdo kusht të mos lejonte realizimin e këtij

akti. Xhonturqit madje urdhëruan vrasjen e organizatorëve të këtij akti. Në këtë mënyre delegatët në mënyrë tejet konspirative marrin rrugën e Vlorës.

28 Nëntor 1912, pasi mbërrijnë atje shumica e delegatëve, në Vlorë mbahet Kuvendi i Pavarsisë. Ismail Bej Vlora zgjidhet kryeministër dhe Ministër i Punëve të Jashtme, dhe Imzot Nikolle Kaçorri nënkryetar i Qeverisë.

Me që Ismail Bej Vlora u zgjodh edhe si Ministër i Punëve të Jashtme, pjesën më të madhe të kohës e kalonte jashtë Shqipërisë, lirisht mund të thuhet se Imzot Nikollë Kaçorri, luante rolin e kryeministrit.

Ja, çfarë shkruante më 2 nëntor 1912, Imzot Nikolle Kaçorri, në memorandum dërguar Mbretit të Austro-Hungarisë Franz Jozefit I:

"Shumë të veshtirë e të rrezikshme janë këto dite për ne shqiptarët e për nanën tonë Shqiperinë që të katër shtetet e Ballkanve po dojnë me e perpi e me coptu".

Të mos harrojmë faktin se ky memorandum i që dërguar Mbretit të Austro-Hungarisë, Franz Jozefit I gjashtembëdhjetë dite para

shpalljes së pavaresisë së Shqipërisë.

Duhet të vihet në dukje fakti se përveç Imzot Nikollë Kaçorrit, nënshkrues të këtij memorandumi janë edhe zotërinjtë, Mustaf Asim Kruja, Rexhep Mitrovica, Fuad Toptani, Abdi Beu, Murat Toptani, Sali Gjuka dhe Bedri Pejani.

Ata përmes këtij memorandumi i kërkonin ndihmë mbretit të Austro- Hungarisë që shteti shqiptar mos të gllabërohet nga sllavet, greket e turqit. Kërkonin të njëjsh shteti shqiptar "ne kater vilajetet e Shqypnisë me Kosovë, Manastir, Shkodër e Janinë".

Ky dokument është me rëndësi, pasi këtu jepet edhe numri i shqiptarëve, që jetonin në vitin 1912, mbi tre milione fryme, dhe qysh atehere u kerkua që Shqipëria me katër vilajetet të jete neutrale siç ishin Zvicra dhe Belgjika.

Pasi qeveria e Ismail Bej Vlorës dështoj, Imzot Nikollë Kaçorri me Mustafa Krujën, Luigi Gurakuqin, Fahri Gjilanin, Themistokli Gërmenjin, themeluan Lidhjen "Për atdheun e për Thronin".

Më pas imzot Nikollë Kacorri emigroi në Austri, ku qëndroi tri vjet në Vjenë, deri sa vdiq më 29 maj 1917.

Fakte rreth Imzot Nikollë Kacorrit

- Imzot Nikolle Kaçorri, u lind ne vitin 1862, në fshatin Kre i Bajrakut te Lures
- 1882, mbaroi kolegjin urban per retorike e gramatike.
- 1882 - 1888, studion ne Romë në kolegjin urban duke kryer 4 vjet për gramatike dhe 2 vjet për retorike.
- 1888-1892, studioi për teologji, filozofi e shkenca politike në Universitetin "Zeking" të Zyrihut në Zvicër.
- 1893, vjen në Shqipëri e shërben fillimisht meshtar në Delbnisht.
- 1893 - 1916, shërben në arkipeshkvinë e Durrësit.
- 1907, kryetar nderi i klubit "Vllaznia".
- 1909, në klubin "Bashkimi".
- 1908 dhe 1909, merr pjesë në Kongreset e Manastirit e Elbasanit.

- 1910 - 1911, u dënua me dy vjet burg "për nxitje kundër ligjeve të shtetit xhonturk".
- 1912 i bashkohet nismës së Ismail Bej Vlorës, për Shpalljen e Pavarësisë.
- 1912, delegat i Durrësit në Kuvendin e Vlorës.
- 4 dhjetor 1912 - 30 mars 1913, zëvendës-kryeministër i qeverisë së parë të Shqipërisë.
- Vdiq në Vjenë më 29 maj 1917.

17.02.2019



Pse u dëbua Nënë Tereza nga krerët e Kishës së Belfastit?

*...influenca dhe emri i mirë, i këtij misioni
bamirës në komunitet, pa përfillur
dallimet politike apo fetare e kishin
zbehur rolin dominant të kishës katolike,
ndaj krerët e saj nuk e toleronin këtë fakt
dhe në vjeshtën e vitit 1973 i dëbuan.*

*Si për ironi të fatit, në 2010,
një monument ngrihet në Ballymurphy,
në përkujtim të punës së vyer të misionit.*

● —————

*Në vitin 1971, Nënë Tereza,
ishte misionare e mirënjohur
ndërkombëtarisht dhe e respektuar
ne mbarë botën për punën
e saj me të varfërit.*

*Kur asaj i erdhi një kërkesë për
ndihmë nga prifti i zonës perëndimore
të Belfastit, Fr. Des Wilson,
ajo u shpreh e gatshme
për të shkuar ne këtë qytet, për të
ndihmuar të varfërit dhe për të
kontribuar ne procesin e paqes.*

————— ●

Shenjtoria Nënë Tereza (1910 -1997), sipas dokumenteve të zbuluara kohët e fundit, në vitin 1973 është përzënë dhe detyruar të largohet nga Irlanda e Veriut. Këtë akt të pashembullt e ka urdhëruar mëkëmbësi i parë i kardinalit të Belfastit, Fr. Padraig Murphy. Po si ka ndodhur kjo histori?

Në vitet 1971 -1973, Irlanda e Veriut ngjante si Shqipëria e viteve 1997-1999. Krizën tragjike dhe të vazhdueshme, që përjetoi Irlanda e Veriut, në

këto vite e përshkruan më se miri një raport i botuar në mars 1975, ku thuhet, '...trazirat e viteve të fundit në Irlandën e Veriut kanë shkaktuar më shumë se 1 100 të vdekur dhe 11 500 të plagosur, si dhe shkatërrime pasurish që arrijnë shumën e mbi 140 milionë paundëve.

Ato kishin formën herë si prishje rendi, herë si akte terrorizmi, që do të thotë dhune e organizuar për qëllime politike apo fetare. Shumica e akteve të terrorizmit vinte nga IRA, e cila falë një organizimi të konsoliduar, përbënte një kërcënim serioz'.

Në vitin 1971, Nënë Tereza, ishte misionare e mirënjohur ndërkombëtarisht dhe e respektuar ne mbarë botën për punën e saj me të varfërit. Kur asaj i erdhi një kërkesë për ndihmë nga prifti i zonës perëndimore të Belfastit, Fr. Des Wilson, ajo u shpreh e gatshme për të shkuar ne këtë qytet për të ndihmuar të varfërit dhe për të kontribuar ne procesin e paqes.

Një surprizë tjetër ishte, që Nënë Tereza jo vetëm vendosi të shkoje, por deklaroi se misioni i saj do të vendosej ne Ballymurphy - një lagje e Belfastit që ishte bombarduar vetëm dy muaj më

parë dhe shkatërruar tërësisht nga dhuna e tmerrshme. Në Gusht të vitit 1971, një prift katolik dhe një nënë e tetë fëmijëve ishin midis 11 njerëzve të vrarë nga Regjimenti Parashutist në atë lagje që u bë e njohur si masakra e Ballymurphy-t

Dy shtëpi në Springhill Avenue

Në atë kohë, çdo banor veç donte të ikte nga ajo lagje, por papritur Nënë Tereza vendos që qendra e misionit të saj dhe katër murgeshat që ishin më të, të vendoseshin pikërisht në këtë lagje. Dy shtëpi në Springhill Avenue, pjesë e lagjes së Ballymurphy u siguruan për motrat e Misionareve të Bamirësisë. Shtëpitë ishin krejt të dëmtuara, por banorët kontribuan dhe i ringritën ato.

Që në fillim, murgeshat njiheshin thjesht si "Motrat e Nënë Terezës". Fr. Wilson e vlerësoi lart punën e këtij 'manastiri' të improvizuar, i cili siç deklaronte ai, ngriti lart moralin e komunitetit. Të rinjtë mblidheshin në shtëpinë e motrave, këndonin, punonin, mësonin zanate të reja, disa mësonin të lexonin dhe të shkruanin.

Kjo shtëpi e Motrave të Nënë Terezës ishte një nga vendet e pakta në atë zonë me një telefon që punonte. Dhe shpesh nënat e shqetësuara vinin për të bërë ankesa apo dhe telefonata të dëshpëruara për mospagesën e përkrahjes sociale ose ankesa për anëtarët e burgosur të familjes. Por pavarësisht se fituan zemrat e gjithë banoreve të Belfastit pa dallim nga besimet e tyre fetare, (protestant apo katolik), murgeshat nuk arritën të fitonin mbështetjen e disa klerikëve të lartë në Kishën Katolike të Belfastit. Kishte një perceptim nga krerët e kishës katolike se puna e këtyre murgeshave ishte një turp për Belfastin, pasi krijonte idenë të tjerët që krerët e kishës këtu nuk janë zotët t'i zgjidhin vetë problemet e banoreve të këtushëm pa një ndihmë nga jashtë.

Dëbimi nga Ballymurphy

Në fillim kundërvenia ishte e kamufluar, por më kalimin e kohës, trajtimi i murgeshave nga ana e kishës u bë i patolerueshëm. Sulmet moren ngjyra dhe forma të konflikteve të hapura.

Sigj duket, influenza dhe emri i mirë i këtij

misioni bamirësie për shërbimet e punët e mira që bënin në komunitet, pa përfillur dallimet politike apo fetare e kishin zbehur rolin dominant të kishës katolike. Dhe krerët e kësaj kishe nuk mund ta toleronin këtë fakt.

Përfundimisht, në vjeshtën e vitit 1973 ato i dëbuan nga Ballymurphy, më saktë i detyruan të largohen. Kisha Katolike e mohoi faktin se e kishin detyruar Nene Terezën dhe murgeshat e këtij misioni të largoheshin dhe thanë që Motrat e Bamirësise kishin ikur me vullnetin e tyre të lire.

Rrëfimi i Eileen Sweeney

Rrëfimi i murgeshës katolike, Eileen Sweeney, e cila punoi pranë këtij misioni, i bërë në një dokumentar të BBC, shpalos të vërtetën tragjike të këtij debimi.

Ajo, tregon me imtësi sulmet e vazhdueshme që disa krerë të kishës katolike u bënin në vazhdimësi këtyre misionarëve. U trondita shumë - thotë ajo, kur një mëngjes kur shkova aty pashe që ato kishin bere gati plaçkat dhe ishin bere gati për të ikur. Pashe lotë në sytë e

Nënë Terezës dhe motrave të këtij misioni. Nënë Tereza më tha shkurt - Po ikim, nuk mund të rijmë më në një vend ku krerët e kishës katolike janë kundër nesh.

Pashë një letër të grisur në copa të vogla hedhur në dysheme. Pasi ato dolën, unë u mundova t'i mbledh dhe t'i ngjis copat e kësaj letre misterioze që i kishte detyruar këto misionare bamirësie të largohen. Ishte një letër e ardhur nga mëkëmbësi i parë i kardinalit të Belfastit, Fr. Padraig Murphy. Ai u thoshte se brenda 24 orëve duhet të largohen nga Ballymurphy, në të kundërt do të përballen me pasoja të paparashikueshme.

Por jo të gjithë krerët e kishës katolike mendonin si Fr. Padraig Murphy. Një muaj pasi ato u larguan, një petition u hartua nga famullitaret e kishave të kësaj zone. Ata vlerësonin punën e këtij misioni bamirësie në Ballymurphy. Në këtë petition ata bënë thirrje për një qasje të re në administrimin e famullise, duke përfshirë krijimin e një këshilli famullitar, më një fjalë në zgjedhjen drejtuesve të ri në hierarkinë e kishës katolike të Belfastit dhe disa



çështje të tjera që prekin komunitetin lokal. Nënë Tereza nuk e harroi kurrë Ballymuphiy-n. Në një lutje në vitin 1981, ajo e falenderon komunitetin e kësaj zone për mbështetjen që i dhane misionit të saj ne ato muaj që shërbyen atje. Ajo shprehet: - Ju sjell lutjen dhe mirënjohjen time për gjithçka keni bere për motrat tona, kur shërbyem atje.

Një monument në shenjë mirënjohje

Kishin kaluar shumë vite nga ky dëbim i pashembullt, por si për ironi të fatit në 2010, një monument ngrihet në Ballymurphy, në përkujtim

të punës së vyer të këtij misioni i kryer më aq shumë devocion në ato vite të trazuara. Misionaret e motrave bamirëse u kthyen ne Ballymurphy ne vitin 2010 dhe pas një ceremonie mbresëlënëse bënë një fotografi para kësaj skulpture ngritur në mirënjohje të punës së tyre.

Nënë Tereza tashmë është shpallur shenjt. Ajo është pranuar si shenjt nga të gjithë - madje edhe ne Ballymuphy ku dikur e patën dëbuar. Atje, ajo ka tani edhe një monument ne shenjë mirënjohje të punës dhe kontributit të vyer të saj dhe motrave të misionit të saj ne ato vite të trazuara për Irlandën e Veriut.

03.03.2019



Pjetër Arbnori, Lordi Bethel dhe spiuni Kim Philby

*...një akt i vogël shpërblimi do të ishte
që, 150.000 paundet, t'u jepen
Muhamet Hoxhës, Selim Dacit,
familjes së Adem Gjures dhe të tjerëve
që vuajtën nga pasojat e veprimtarisë
anti-ligjore të këtij dubël agjenti.
Por, mbi të gjitha, paratë nuk duhet të
shkojnë kurrësi për familjen Philby.*

● —————

*Pjetër Arbnori, vendos t'i shkruaje
letër mikut të tij, Lordit Bethel,
i cili sapo merr këtë letër, me
përgjegjësinë e një politikani karriere
dhe të historianit dinjitoz, ulet dhe
shkruan një artikull të gjatë rreth kësaj
çështje, i detajuar dhe me informacion të
rëndësishëm rreth rolit të Philby-it dhe
viktimave shqiptare që ka shkaktuar
veprimtaria e tij spiunuese për llogari të
KGB dhe organet e Sigurimit shqiptar
të këtij dubel agjenti.*

————— ●

Në vitin 1994, Pjetër Arbnori i shkruan letër, njërit prej Lordëve më të shquar të Britanisë së Madhe, Nicholas Bethel. Duke marrë shkas nga kjo letër e Arbnorit, Lordi Bethel më 6 Shtator 1994, botoi një shkrim të gjatë në gazetën Independent, që është gazeta me prestigjioze e Mbretërisë së Bashkuar.

Pjetër Arbnori, në rolin e tij si Kryetar i Parlamentit të Shqipërisë, i kërkon Lordit Bethel që të përdorë autoritetin e tij, për të bindur

drejtuesit e Sotheby's që përfitimet e disa shitjeve me ankand, që ato po bënë t'u jepeshin disa të persekutuarve politikë në Shqipëri.

Në Korrik të vitit 1994, vetëm gjashtë vjet pas vdekjes së spiunit të famshëm Kim Philby, korporata me famë botërore për shitjet me ankand të objekteve me vlerë historike, Sotheby's, pasi kishte blerë në Moskë apartamentin dhe të gjitha objektet e spiunit Kim Philby, vendos t'i shesë ato me ankand, dhe paratë e grumbulluara nga këto shitje t'i japë për bamirësi.

Pjetër Arbnori, sapo e mëson këtë lajm vendos menjëherë t'i shkruajë letër mikut të tij, Lordit Bethel, i cili sapo merr këtë letër, me përgjegjësinë e një politikani karriere dhe të historianit dinjitoz, ulet dhe shkruan një artikull të gjatë rreth kësaj çështje. Artikulli i Lordit Bethel, është i detajuar dhe me mjaft informacion të rëndësishëm rreth rolit të Philby-it dhe viktimave shqiptare që ka shkaktuar veprimtaria e tij spiunuese për llogari të KGB dhe organet e Sigurimit Shqiptar të këtij dubel agjenti.

Para se të flasim rreth asaj që i lidh këto tre persona e shoh me vend të shpjegoj, se kush ishin ata:

Pjetër Arbnori (18 Janar 1935 - 8 Korrik 2006), shkrimtar dhe politikan shqiptar. Ai është quajtur "Mandela i Ballkanit", për shkak të kohës së gjatë, plot 28 vjet, që kaloi në burgjet e diktaturës komuniste. Ai ishte bashkëthemelues i degës së Partisë Demokratike në Shkodër. Prej vitit 1991-2001, deputet në Parlamentin e Shqipërisë dhe gjatë periudhës 1992 -1997, Kryetar i Parlamentit Shqiptar.

Lord Nicholas William Bethell, (19 Korrik 1938-8 Shtator 2007) ka qenë politikan britanik, historian për Europën Qendrore dhe Lindore, anëtar i Dhomës së Lordëve si konservator nga viti 1967-1999, anëtar i Parlamentit European nga viti 1979 - 1994 dhe 1999 - 2003.

Në mesin e shumë librave që botoi është edhe ai me titull "The great betrayal" (Tradhtia e madhe), ku flet për rolin e agjentit Kim Philby.

Kim Philby, (1912-1988) ishte spiun sovjetik. Në vitin 1963, qeveria britanike pranon se ish-

diplomati i saj, Harold Adrian Russell, Kim Philby, kishte vepruar si agjent sovjetik. Dezertimi i tij në Bashkimin Sovjetik në Janar 1963, ishte një prej momenteve më dramatike të Luftës së Ftohtë.

Në kohën kur ishte me detyrë në Washington në fillim të viteve 1950, si ndërmjetës mes shërbimeve sekrete britanike dhe atyre amerikane, Philby, tradhtoi operacionin sekret të dërgimit të mijëra shqiptarëve të arratisur në vendin e tyre, për të përmbysur regjimin komunist të Enver Hoxhës.

Philby pasi u përjashtua nga shërbimi i zbulimit Britanik MI6 u arratis në Moskë. Ai vdiq në vitin 1988, në moshën 76 vjeçare. Philby është cilësuar si një prej spiunëve më dinakë të shekullit XX.

Në përmbyllje të artikullit të tij, Lordit Bethel, botuar plot 25 vjet më parë, i nxitur nga letra që kishte marrë nga kryetari i Parlamentit Shqiptar, Lordi Bethel ndër të tjera shkruan: "Shpërblimet e majme që kishte përfituar Kim Philby nga ana e KGB-se dhe Bashkimit Sovjetik ishin të pa merituar.

Kjo pasi ai me veprimtarinë e tij anti-ligjore shkaktoi me qindra viktima e shkatërroi me mijëra jetë shqiptarësh.

Dhe, si për ironi të fatit, shkruan Bethel, në këmbim të gjithë kësaj tragjedie atij iu dhuruan 25 vjet jetë e privilegjuar në Moskë dhe shumë dhurata materiale, disa prej të cilave u paraqitën për ankand në Sotheby's në 19 Korrik 1994.

Kjo, mendoj, thotë ai, është një temë që do trajtuar me kujdes. Paratë e fituara nga këto objekte të shitura janë fitimet të ardhura nga akte të tradhtisë, veprime të cilat jo vetëm qe shkatërruan shumë jetë, por edhe shkelën ligjin Anglez".

Lordi Bethel, në artikullin e tij, thotë se e mbështet plotësisht propozimin e kryetarit të Parlamentit të Shqipërisë dhe sipas mendimit të tij, një akt i vogël shpërblimi do të ishte që, 150.000 paundet e përfituara nga këto shitje t'u jepen Muhamet Hoxhës, Selim Dacit, familjes së Adem Gjures dhe të tjerëve që vuajtën nga pasojat e veprimtarisë anti-ligjore të këtij dubël agjenti. Por, mbi të gjitha, paratë

nuk duhet të shkojnë kurrsesi për familjen Philby.

As ata, as Sotheby's nuk duhet të përfitojnë nga shitja e objekteve që janë fituar nga akte të paligjshme të një zyrtari Britanik që tradhtoi interesat e vendit të tij për llogari të KGB-së, Bashkimit Sovjetik dhe organeve të Sigurimit Komunist Shqiptar.

09.06.2019



Takim me një "hajdut"
të bibliotekës së
Mbretëreshës Geraldinë

*Josephine Dedet, në librin e saj
"Geraldina, Mbretëresha e Shqiptarëve"
thotë se ajo kishte një bibliotekë me
mbi 7000 libra, lexonte pareshtur dhe
zotëronte mjaft mirë në të shkruar,
lexuar e folur: frëngjisht, shqip,
hungarisht, gjermanisht, anglisht.*

● —————

*Në Amazon gjeta dhe bleva online
një libër të përdorur të botuar në
vitin 1984. Libri titullohet
"Tradhtia e madhe" dhe flet mbi
veprimtarinë e kryespiunit Phibby.*

*Nuk po u besojë syve. Si ka
mundësi?! Një libër që i është dhuruar
Mbretëreshës Geraldinë me një
dedikim personal nga një autor si
Bethell, që ishte pa dyshim Lordi më
erudit i Mbretërisë Angleze, të shitet në
Amazon nga ca 'hajdutë' ordiner.*



————— ●

Mbretëresha Geraldinë (1915 - 2002), pasionin më të madh të saj kishte librat. Autorja franceze, Josephine Dedet, në librin e saj me titull "Geraldina, Mbretëresha e Shqiptarëve" të botuar para disa vitesh thotë se ajo kishte një bibliotekë me mbi 7000 libra, lexonte pareshtur dhe zotëronte mjaft mirë në të shkruar, lexuar dhe folur frëngjisht, shqip, hungarisht, gjermanisht dhe anglisht.

Është shkruar pak ose më saktë aspak për

këtë dimension të jetës së saj. Nuk dihet asgjë rreth fatit të kësaj biblioteke gjigande të ngritur me aq pasion e dashuri prej saj. Nuk i njohim 'hajdutët' që vodhën librat e bibliotekës së saj. Por unë pata fatin që virtualisht ta takoj njërin prej këtyre....

Pas një shkrimi mbi Kim Philbyn-n , regjisori i njohur Ylli Pepo, më kontaktoi dhe më tha se po përgatit një film dokumentar mbi këtë personazh, duke më kërkuar ndihmë t'i gjeja një film dokumentar të



transmetuar në kanalin televiziv RTW në Irlandë në vitin 2009. E gjeta filmin dhe ia dërgova. Thirrja e Pepos me zgjoi një interes të fjetur për të hulumtuar me tej mbi Philby-n.

Në Amazon gjeta dhe bleva online një libër të përdorur të botuar në vitin 1984. Libri titullohet "Tradhtia e madhe" dhe flet mbi veprimtarinë e kryespiunit Phibly. Autor i këtij libri është njëri nga Lordët më në zë në historinë e Britanisë së Madhe, përkthyesi dhe historiani i njohur Nicholas Bethell (1938 - 2007).

Pas nja 15 ditësh libri mbërriti. E hapa atë zarf me padurimin dhe kureshtjen e një fëmije. Një dedikim i shkruar mbi atë libër me një stilograf thoshte: *"For H.M. Queen Geraldine with all the best wishes and thanks from Nicholas Bethell"*.

E lexova këtë fraze nja njëzet herë. Nuk po u besoja syve. Si ka mundësi?! Një libër që i është dhuruar Mbretëreshës Geraldinë me një dedikim personal nga një autor si Bethell, që ishte pa dyshim Lordi më erudit i Mbretërisë Angleze të gjysmës së dytë të shekullit XX, të shitet në Amazon nga ca 'hajdutë' ordiner. Në fillim mendova se ky dedikim me shkrim dore

nuk është origjinal por është ndonjë shaka e dikujt. Vendosa të bej diçka për ta verifikuar.

Po nga t'ja nisja? Mbretëresha Geraldinë ka vdekur që në 2002, Lordi Bethell që në 2007.

Kërkova në internet dhe gjeta djalin e Lordit Bethell, James Bethell. Edhe ai Lord, pasi ka trashëguar titullin, si djali i madh i tij. Aktualisht, anëtar i Parlamentit Britanik. Të vetmin kontakt që munda të gjej ishte një email i tij. Email jo personal, por i punës si parlamentar. I shkruajta...

Pasi i shpjegova historinë dhe i bashkëngjita foton me dorëshkrimin e dedikimit të shkruar nga babai i tij e pyesja nëse ky ishte me të vërtetë shkrimi i të atit. Pa kaluar as 20 minuta në emailin tim mbërriti përgjigja nga Lordi James Bethell. Ai e konfirmonte këtë dedikim si shkrim origjinal i të atit: *"Yes, that is indeed his distinctive writing. The quirky "e" comes from too much time studying Greek. How lovely to hear from you."*

U hutova për një moment. Si ka mundësi, thashë me vete. Autografi ishte origjinal. Dhe për me tepër më surprizoi fakti se si një anëtar i



Parlamentit Britanik dhe Lord në të njëjtën kohë, i përgjigjet emailit që merr nga një shqiptar, në me pak se në 20 minuta. Shkëmbyem disa emaile të tjera. Më dha numrin e celularit të tij. E lamë të takohemi.

Një muze për Mbretëreshën Geraldinë

Shqiptarët kanë qenë dhe janë të ndarë në qëndrimet e tyre mbi Mbretin Zog. Por e kundërta ka ndodhur me Mbretëreshën Geraldinë. Nuk

ka qoftë edhe një shqiptar të vetëm të ketë thënë një fjalë të keqe për të, madje as gjatë regjimit komunist.

Motivet e këtij fenomeni, le t'i studiojnë historianët apo antropologët. Por, ne si komb, i detyrohemi shumë kësaj gruaje fisnike. Ajo me zgjuarsinë, mirësinë dhe kontributin e saj, i ka bërë një shërbim të shkëlqyer Shqipërisë. Janë mbi 4800 citime në libra të autoreve të ndryshëm të botuar në shumë gjuhë të botës që i referohen jetës dhe veprimtarisë së saj. Nga një kërkim i shpejtë në Google për emrin e saj të shfaqen 8,160,000 rezultate në (0.53 sekonda) - referenca online. Shifër kjo shumë herë më e lartë se për çdo personalitet tjetër të botës politike apo jo politike shqiptare. ('Hajdutët' e bibliotekës së saj nuk shfaqen me emër, megjithëse janë aty të maskuar duke shitur ne Amazon librat e bibliotekës së saj, atë pasuri që ajo e donte aq shumë).

Një museum mbi jetën e saj do i bënte nder Shqipërisë dhe do kthehej në një destinacion turistik për shqiptarët, hungarezët, amerikanët, francezët, e shumë të tjerë nga mbarë bota.

Pak histori mbi Mbretëreshën Geraldinë

Mbretëresha Geraldinë, më vonë Nëna Mbretëreshë Geraldinë ose Kontesha Geraldinë Margit Virginia Olga Mária Apponyi de Nagyappony ishte mbretëresha e shqiptarëve dhe bashkëshortja e Mbretit Zogu I dhe nëna e Leka Zogut.

Ajo rrjedh nga një familje shume e njohur Hungareze. Të gjithë paraardhësit e familjes Appony kanë pasur karrierë shumë të suksesshme politike dhe kanë mbuluar detyra nga më të rëndësishmet shtetërore në Perandorinë Austriake. Nëna e Mbretëreshës Geraldine, Gledis Virxhinia Stjuart, ishte kushërira e ish- presidentit Amerikan Ricard Nikson.

Mbretëresha Geraldinë, gjatë periudhës së shkurtër të qëndrimit në Shqipëri, kontribuoi për ngritjen dhe funksionimin e institucioneve në shërbim të shtresave në nevojë, si spitalet, azilet dhe jetimoret. Ajo dha një ndihmesë të madhe për ngritjen dhe funksionimin e spitalit Ushtarak

në Tiranë, dhe solli nga Austria mjekë shumë të mirë për drejtimin e këtij Spitali. Ajo themeloi Maternitetin e parë shqiptar në Tiranë, rihapi Kryqin e Kuq Shqiptar dhe mundësoi hapjen e edicionit të parë radiofonik në Radio Tirana.

Të gjitha këto, dhe së fundmi gjesti i saj fisnik për t'u kthyer e të jetuar muajt e fundit të jetës, si besnike shqiptare në tokën e vendit të saj të adoptuar, përbën për shqiptarët një detyrim sublim për t'i ngritur muze dhe një përmendore të madhe në mes të Tiranës.

01.09.2019



Nevoja për një Ismail Bej Vlore... real!

*Shqiptarët duhet të mësojnë të vërtetën
rreth mënyrës se si Ismail Bej Vlora
u zgjodh në postin e kryeministrit të
parë shqiptar, si dhe motivet e
dorëheqjes së tij. Ai duhet t'u paraqitet
atyre në përmasat e tij dhe jashtë
glorifikimeve dhe mitizimit.*

● —————

*Le të ndalemi tek momenti i
dorëheqjes së Ismail Bej Vlorës nga
postu i kryeministrit. Çfarë dinë
shqiptarët rreth këtij akti? Kush ia
kërkoj dhe pse? Çfarë pazgresh të
fshehta kishte bërë me Esat Pashë
Toptanin, për të sjellë si princ në
Shqipëri, Ministrin e Luftës së
Perandorisë Osmane, Izzet Pasha?
Cilat ishin akuzat që Komisioni
Ndërkombëtar i Kontrollit, lidhur me
keqpërdorimin e fondeve, etj.?*

————— ●

Ka mbetur vetëm pak javë nga dita e 107 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë. Mendoj se ky vit përbën momentin më të përshtatshëm, për t'iu servirur më në fund shqiptarëve portretin real të Ismail Bej Vlorës. Ai duhet t'u paraqitet atyre në përmasat e tij dhe jashtë glorifikimeve dhe mitizimit. Kjo pasi për shumë dekada, figura e këtij diplomati karriere dhe burri shteti u mitizua ekstremisht. U arrit deri atje sa iu ndërrua madje edhe mbiemri.

Duke shpalosur para shqiptarëve, një Ismail Bej Vlorë, real, njerëzor, me meritat, zotësitë, gabimet dhe frikërat e tij, ne, realisht nuk ia zbehim aspak madhësinë, por e bëjmë figurën e tij më të besueshme për shqiptarët e vitit 2019, të cilët për hir të së vërtetës nuk mund të pranojnë me shabllone të mitizuara heronjsh.

Në këtë kontekst, them se shqiptarët e vitit 2019, duhet të dinë me ekzaktësi dhe jashtë ndikimeve politike apo fetare, motivet reale që e shtynë Ismail Bej Vlorën drejt vendimit për ta shpallur Shqipërinë të 'mosvarme'. Cilat ishin opsionet e tjera në lojë gjatë atyre muajve kur lufta Ballkanike sapo kishte nisur, dhe pse opsioni i tij që më largpamësi, dhe më i dobishmi për vendin në atë moment?

Shqiptarët e 2019-ës duhet të mësojnë të vërtetat e paretuara rreth nxitimit të tij, dhe të Austro-Hungarezëve të cilët qëndronin pas tij, për të shpallur pavarësinë me aq ngut, megjithëse qeveria që ai do drejtonte nuk kishte nën kontroll as një të katërtën e territoreve të banuara nga shqiptarët.

Shqiptarët në këtë 107-vjetor duhet të mësojnë

të vërtetën rreth mënyrës se si Ismail Bej Vlora u zgjodh në postin e kryeministrit të parë shqiptar, si dhe motivet e dorëheqjes së tij.

Izet Pasha, Esat Pasha
dhe Ismail Bej Vlora

Mendoj se tani pas 107-vjetësh të vërtetat duhen thënë ashtu siç janë, nën dritën e fakteve dhe dokumenteve, dhe jo të vazhdohet me gjuhen e glorifikimeve nacional-socialistë, si për shembull me 'plaku i urtë', 'udhëheqësi largpamës, e mjekërbardhë', e të tjera folklorizma si këto.

Më konkretisht: Le të ndalemi për shembull tek momenti i dorëheqjes së Ismail Bej Vlorës nga posti i kryeministrit. Çfarë dinë shqiptarët rreth këtij akti? A e dinë vallë ata, se kush ia kërkoi këtë dorëheqje Ismail Bej Vlorës dhe pse? Çfarë pazaresh të fshehta kishte bërë ai me Esat Pashë Toptanin, për të sjellë si princ në Shqipëri, Ministrin e Luftës së Perandorisë Osmane, Izet Pasha? Cilat ishin akuzat që Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit, i kishte bërë Ismail Bej

Vlorës, lidhur me keqpërdorimin e fondeve të grumbulluara nga doganat e këtij qyteti, etj.?

Të vërtetat e këtyre pyetjeve që parashtrova nuk ia zbehin aspak madhështinë kësaj figure. Ato veç e bëjnë këtë figurë me realiste, më të besueshme, më njerëzore. Dimensione këto që fatkeqësisht i mungojnë jo vetëm këtij lideri historik, por krejt historiografisë shqiptare. Për të ilustruar idenë time rreth domosdoshmërisë së ç'mitizimit të heronjve tanë, dëshiroj të rendis këtu shkurtimisht kushtet në të cilat Ismail Bej Vlora që i detyruar të japë dorëheqjen.

Shqipëria në kaos total

Në Tetor-Nëntor 1912, Shqipëria ishte në një kaos total. Forcat greke dhe serbo-malazeze po kryenin masakra në Veri dhe në Jug të Shqipërisë. Godina e rrëzuar e shtetit Osman kishte krijuar tek fqinjët tanë ortodoks, premiset për dhunë, vrasje e spastrime etnike. Për t'i bërë ballë kësaj situatë, u projektua aleanca turko-bullgaro-shqiptare. Me 13 Gusht 1913, kongresi xhonturk vendosi që të dërgonte në Shqipëri si



Princ të vendit, ministrin Osman të Luftës, Izet Pashën, që ishte me origjinë shqiptare. Ky vendim iu njoftua edhe Ismail Bej Vlorës dhe Esat Pashë Toptanit.

Sipas informacioneve që posedonin kolonelët e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, (Misioni Hollandez), që operonin në Shqipëri në atë kohë, Ismail Bej dhe Esat Pasha ishin marrë vesh me njëri-tjetrin, dhe kishin rënë dakord që Izet Pasha të vinte në Shqipëri dhe të ishte Princi i ardhshëm i Shqiptarëve.

Për realizimin e këtij plani, u dërgua paraprakisht në Shqipëri, Beqir Gebrene Aga, që do të diskutonte me Ismail Bej Vlorën, Esat Pashë Toptanin dhe liderët e tjerë shqiptarë, rreth forcave ushtarake dhe armatimeve për të shpartalluar invazionin panortodoks në Ballkan, dhe për të krijuar një shtet të unifikuar shqiptar. Por ishte Syrja Bej Vlora, (kushëri i parë i Ismail Bej Vlorës), ai që e dekonspiroi këtë plan, duke spiunuar kundër Ismailit dhe Esatit, tek Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit, dhe tek konsulli serb në Vlorë, Gavrilloviç.

Çfarë ndodhi më 6 Janar 1914?

Pas këtij spiunimi, me 6 Janar 1914, Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit, nisi kontrollin mbi disa anije austriake, (që ishin mbështetëse të planit për sjelljen e Izet Pashës në Shqipëri). Oficerët hollandezë të këtij Komisioni zbuluan gjatë këtij kontrolli në këto anije mjaft armatime dhe ushtarë.

Ata arritën të arrestojnë rreth 200 ushtarë shqiptarë, të cilët qëndronin të fshehur në këto anije. Plan i për sjelljen e Izet Pashës si Princ në Shqipëri, i shqetësoi autoritetet e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, ndaj dhe ata arrestuan shume të dyshuar si pjesëmarrës në këtë plan, si dhe morën në pyetje shumë udhëheqës e militantë shqiptarë, si Çerçiz Topullin, Ismail Bej Vlorën, Esat Pashën e shume të tjerë.

Vendimi i Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit

Koloneli Hollandez Der Veer, i cili drejtoi këtë operacion e dënoi me vdekje Beqir Gebrenenë, i cili në atë kohë konsiderohej si heroi shqiptar

kundër shovinizmit grek. Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit e akuzoi Ismail Bej Vlorën dhe Esat Pashën si komplotues.

Ky Komision, e akuzoi Ismail Bej Vlorën edhe për keqpërdorimin e fondeve të grumbulluara nga doganat e këtij qyteti dhe i kërkoi atij të japë dorëheqjen nga posti i Kryeministrit të Qeverisë së Vlorës, si dhe largimin nga Shqipëria, para datës 25 Janar 1914.

21. 10. 2019

PASQYRA E LËNDËS

NGJARJE E NDODHIRA INTERESANTE
DHE TË RËNDËSISHME,
POR THUAJSE TËRËSISHT TË HARRUARA

nga **MAL BERISHA**

Ish-ambasador, historian, shkrimtar dhe përkthyes

3

Paganizmi dhe... turizmi

9

**Tenison,
libri i tij "Land of Eagles",
dhe... një ministër shqiptar!**

15

**Si iu dhurua Hrushovit,
kostumi i Preng Bibë Dodës?**

25

**Rexh Meta dhe
kushti i Enverit
për Rose Wilder Lane**

33

**Ndoshta e Treta...
sepse Lidhja e Dytë e Prizrenit
është mbi 70 vjeçare dhe ka histori**

41

**Sikur të bënim modelin
irlandez për historinë!**

51

Meave de Burgh
agjentja sekrete britanike
që admironte shqiptarët
61

Imzot Kaçorri
përballë mbretit të
Austro-Hungarisë,
Franz Jozefi I
67

Pse u dëbua
Nënë Tereza nga krerët
e Kishës së Belfastit?
77

Pjetër Arbnori,
Lordi Bethel
dhe spiuni Kim Philby
87

Takim me një "hajdut"
të bibliotekës së
Mbretëreshës Geraldinë
95

Nevoja për një
Ismail Bej Vlore... real!
105